

VËSHTRIM në Udhëzuesin Burimor #SOFJO për pjesëmarrësit në SEEMC 2020

Në pritje të publikimit të Udhëzuesit Burimor #SOFJO në tetor 2020, Zyra e Përfaqësuesit për Lirinë e Medias u ofron pjesëmarrësve të Konventës për Median në Evropën Juglindore një panoramë të katër kapitujve të përzgjedhur. Këta kapituj fokusohen te roli i ekzekutivit, gjyqësorit dhe agjencive ligjzbatuese për të kuptuar më mirë sigurinë e gazetareve *online*. Udhëzuesi Burimor #SOFJO ka për autorë Dr. Silvia Chocarro, Sarah Clarke, Paulina Gutierrez dhe Judy Taing.

Kjo do të kontribuojë në diskutimet e Panelit IV: Përpjekjet për t'u Mbyllur Gojën Gazetareve: Nga Portretizimi te Ngacmimi *Online*.

Zyra e Përfaqësuesit për Lirinë e Medias fton për bashkëpunim në Udhëzuesin Burimor.

Lutemi kontaktoni: Kryekëshilltarin Kristin.Olson@osce.org ose Oficeren e Projektit Julia.Haas@osce.org.

Pasqyra e lëndës

1. Prezantimi i Udhëzuesit Burimor#SOFJO
2. Vështrim në 3 kapitujt që trajtojnë:
 - a. Pushtetin ekzekutiv
 - b. Pushtetin gjyqësor
 - c. Organet ligjzbatuese

1. Prezantimi i Udhëzuesit Burimor #SOFJO

Siguriae Gazetareve në Internet (*Online*) – #SOFJO

Siguria në internet e gazetareve shkon përtej barazisë gjinore dhe lirisë së shtypit, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e demokracive tona dhe në të drejtën e shoqërisë për akses në pluralitet informacioni.

Gratë gazetare përballen me një barrë të dyfishtë: ato sulmohen si gazetare dhe si gra. Në kutitë e tyre të postës elektronike dhe në llogaritë që kanë në mediat sociale, u vijnë gjatë një dite pune kërcënime për përdhunim, dhunë fizike dhe imazhe grafike. Në vitin 2015, e alarmuar nga numri gjithnjë në rritje i raportimeve në mbarë rajonin e OSBE-së për gazetare dhe blogere që sulmoheshin ashpër në internet, zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias (PLeM) nisi Projektin për Sigurinë e Gazetareve *Online* (#SOFJO).

Projekti #SOFJO nisi si një platformë globale për zhvillimin e strategjive për të luftuar pasojat që ka ngacmimi *online* në jetën dhe punën e gazetareve, si dhe ndikimin që kanë këto lloj kërcënimesh dhe abuzimesh serioze ndaj pluralizmit mediatic. Gjatë viteve të para, fushata #SOFJO pati si synim ndërgjegjësimin për mbizotërimin e këtij lloj ngacmimi, si dhe shkëmbimin e historive të gazetareve që kishin qenë shënjestër e tyre. Gjatë projektit, në përpjekje për rritjen e ndërgjegjësimit dhe për të frymëzuar ndryshime, zyra PLeM bashkë me aktorë të tjerë, zhvilloi dhe mbështeti studime e publikime të hollësishme, si dhe ka nxjerrë një sërë rekomandimesh për qeverinë, operatorët mediatikë dhe aktorë të tjerë.

Si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të Zyrës për promovimin dhe garantimin e sigurisë së gazetareve, në vitin 2018, Zyra PLeM, në bashkëpunim me Institutin Ndërkombëtar të Shtypit (IPI), prodhoi dokumentarin “Një Vend i Errët” (*A Dark Place*) për të nxjerrë në pah përvojat e gazetareve që kanë qenë objekt ngacmimi *online*. Ky dokumentar eksploron mënyrat se si ky fenomen dhe problematikat që mbart shkojnë përtej barazisë gjinore, duke ndikuar drejtpërdrejtë në lirinë e medias dhe në të drejtën themelore të njeriut dhe shoqërisë në tërësi për akses në pluralitet informacioni.

Hapi tjetër i radhës në këtë projekt, gjatë gjashtë muajve të fundit, ishte hartimi nga ana e Zyrës PLeM i një Udhëzuesi Burimor të detajuar #SOFJO, i cili synon të ndihmojë Shtetet dhe t'u japë orientime të gjithë aktorëve përkatës për të përmirësuar sigurinë e gazetareve *online*. Ky Udhëzues Burimor #SOFJO do të plotësojë boshllëqet që ekzistojnë ende në adresimin e sigurisë së gazetareve *online*, si dhe do të kontribuojë për të përkthyer në praktikë rekomandimet dhe politikat e hartuara deri tani. Ky Udhëzues do të ofrojë edhe një sërë hapash konkretë që propozohen për dhjetë aktorë kyçë, si shtetërorë dhe joshetërorë, plotësuar me burime të

tjera dhe me shembuj praktikash të mira për të ofruar disa orientime për zbatimin e standardeve dhe angazhimeve ndërkombëtare për sigurinë e gazetarëve.

Abuzimi gjinor online i gazetarëve

63% e gazetarëve kërcënohen ose ngacmohen *online* në një moment të caktuar thjesht se bëjnë punën e tyre. Gazetarët kanë 4 herë më shumë gjasa që të përjetojnë këto lloje sulmesh krahasuar me homologët e tyre meshkuj, sipas një sondazhi të “*The Guardian*”¹.

Për pjesën më të madhe të gazetarëve në botë, abuzimi dhe ngacmimi *online* është kthyer në një rrezik të madh për këtë profesion, një rrezik që kërcënon aftësinë e tyre për të bërë punën, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes, si dhe duke penguar aksesin e lirë dhe të hapur në informacion për të gjithë anëtarët e shoqërisë. “Unë kam menduar edhe të dal plotësisht nga mediat sociale”, thotë redaktorja politike e BBC-së, Laura Kuenssberg, në dokumentarin “*A Dark Place*” nga PLeM dhe IPI, “por njerëzit që janë aty, që duan informacione, që është edhe gjëja më e rëndësishme për mua, janë ata që humbasin e, pastaj, humbas edhe unë”.

Të gjithë gazetarët në botë përballen me kërcënime e dhunë gjithmonë e më të madhe si rrjedhojë e punës së tyre. Shumë shpesh ndodh që çmimi i raportimit të së vërtetës vjen në formë kërcënimesh, mbikëqyrjeje, sulmesh, arrestimesh arbitrare dhe shoqërimin nga policia dhe, në rastet më të rënda- në zhdukje dhe vrasje të detyruara. Qeveritë dhe aktorët e tjerë të fuqishëm vazhdojnë t’u mbyllin gojën atyre që u kërkojnë llogari, në përpjekje për t’i shpëtuar monitorimit dhe për të mbytur kundërshtitë.

Gratë gazetarë përballen edhe me një tjetër rrezik, posaçërisht për shkak të gjinisë së tyre. Askund tjetër nuk është kjo tendencë më e fortë sesa në ngacmimet dhe abuzimet me bazë gjinore *online*. Manifestimet e ngacmimeve dhe abuzimeve *online* mund të variojnë nga kërcënime direkte dhe indirekte për dhunë fizike dhe seksuale, mesazhe ofenduese dhe ngacmime të qarta (shpesh në formë të koordinuar [*pile-on*], domethënë persona të ndryshëm që koordinohen kundër një individi të vetëm), shkelja e privatësisë (si përndjekja, shpërndarja jokonsensuale e imazheve intime [*doxing*], domethënë publikimi i informacioneve private si për shembull, publikimi i adresës së shtëpisë së personit që vihet në shënjestër). Secila prej këtyre formave mund të përkufizohet ndryshe në legjislacionet e vendeve përkatëse apo në rekomandimet e organeve ndërkombëtare apo rajonale të të drejtave të njeriut. Institucionet e tjera si kompanitë e mediave sociale apo akademikët kanë prodhuar edhe një fjalor të tyre për të dhënë konceptin e secilit fenomen.

Ndonëse edhe meshkujt gazetarë janë viktimat e ngacmimeve dhe abuzimeve *online*, format dhe shpeshtësia e sulmeve me të cilat përballen gratë gazetarë janë veçanërisht shqetësuese, duke i bërë shumë gazetarë që të kufizohen në punën e tyre apo të shohin edhe mundësinë e largimit nga ky profesion. Të paktën 40% e gazetarëve janë shprehur se i janë shmangur raportimit të ngjarjeve të caktuara si rrjedhojë e ngacmimeve *online*. Dhuna ndaj gazetarëve nuk ndodh në zbrazëti; ajo është thelbësisht e lidhur me mënyrën se si nënshtrohen gratë në shoqërinë patriarkale dhe se si faktorë të ndryshëm që lidhen me këtë cenojnë barazinë gjinore, si hendeuku në paga, përjashtimi nga proceset vendimmarrëse, si dhe barra më e madhe që u bie grave për shkak të kujdesit të papaguar në familje. Gratë gazetarë janë shpesh shënjestra kur bien shumë në sy në punën e tyre, sidomos kur sfidojnë norma dhe stereotipe të hershme gjinore. gazetarët përballen me sulme jo vetëm nga ata që tentojnë të eliminojnë mbulimin e tyre mediatik, por edhe nga burimet dhe kolegët e tyre, e madje edhe nga vetë pjesëtarët e familjes. Në shumë raste, ato nuk ndihen të sigurta as edhe në vendet ku presupozohet të jenë të mbrojtura si për shembull, në redaksitë e tyre².

¹Michelle Ferrier, *Sulmet dhe Ngacmimet: Ndikimi të gazetarit gra dhe raportimet e tyre*, (Washington: Fondacioni Ndërkombëtar i Medias për Gratë, TrollBusters, 2018 <https://www.iwmf.org/wp-content/uploads/2018/09/Attacks-and-Harassment.pdf>).

²Becky Gardiner, et. al., “Ana e errët e komenteve në Guardian”, *The Guardian*, 12 prill 2016, <https://www.theguardian.com/technology/2016/apr/12/the-dark-side-of-guardian-comments>.

³ARTICLE 19. *Raporti Global për Shprehjen 2018/19*, (Londër: ARTICLE 19, 2019). <https://www.article19.org/xpa-2019/>.

⁴Ibid.

⁵ARTICLE 19 & ILGA Europe, “Kërkese për ndërhyrje nga palë të treta në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Andrea Giuliano dhe Hungaria, Aplikimi Nr. 45305/16”, 2 mars 2020, <https://www.article19.org/wp-content/uploads/2020/03/Guiliano-v-Hungary-Submission-2-March-2.pdf>.

⁶Ibid.

⁷APC, “Dhuna me bazë gjinore online: Parashtrim nga APC drejtuar Raportuesit të Posaçëm të OKB-së për dhunën ndaj grave, shkaqeve dhe pasojave të saj”, 2017, https://www.apc.org/sites/default/files/APCSubmission_UNSR_VAW_GBV.pdf.

⁸Te ai dokument, fundshënimi 3

⁹Raport nga Raportuesi i Posaçëm për dhunën ndaj grave, shkaqeve dhe pasojave të saj, *Lufta ndaj dhunës ndaj grave gazetarë* (Nju Jork: Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i të Drejtave të Njeriut, 2020), <https://undocs.org/en/A/HRC/44/52>.

¹⁰Silvia Chocarro, *Siguria e grave gazetarë: Shkëputja e ciklit të heshtjes dhe dhunës. Seria e librave për Mbrojtjen e Gazetarisë*, (Danimarkë, Mbështetja Ndërkombëtare për Median, 2019), <https://ëëë.mediasupport.org/publication/the-safety-of-women-journalists/>.

Është e qartë se kërcënimet dhe sulmet me të cilat përballen gazetarët, si dhe ndikimi që kanë këto kërcënime dhe sulme, janë shpesh të lidhura dhe variojnë sipas gjinisë dhe faktorëve të tjerë, si raca dhe etnia, besimi fetar apo besime të tjera, orientimi seksual, mosha dhe grupi social. Aktorët që i rëndojnë këto fenomene, ku përfshihet edhe të punuarit si profesionistë të pavarur (*freelancers*), apo mbulimi i temave që kanë rezultuar më me rrezik, si korrupsioni, krimi i organizuar, çështjet mjedisore, të drejtat e njeriut dhe në veçanti të drejtat e grave, pa përmendur rrezikun e mbulimit të situatave të konfliktit. Të kuptuarit e këtyre dallimeve dhe mënyrave se si mund të përjetohen kërcënime të caktuara ndryshe nga gazetarë që u përkasin grupeve të ndryshme krahasuar me homologët e tyre, është thelbësore për hartimin e masave të hollësishme dhe të përshtatura për të parandaluar, për të mbrojtur dhe për të zgjidhur sulmet ndaj gazetarëve. Për fat të keq, në shumë pjesë legjislativi, politika publike dhe masa të tjera të ndërmara nga shtetet e ndryshme mungon ky dimension gjinor dhe ndërsektorial.

Çfarë mund të bëjnë aktorët kryesorë

Ky udhëzues burimor #SOFJO ka për qëllim të plotësojë boshllëqet që ekzistojnë në adresimin e sigurisë së gazetarëve *online*. Gjatë dekadës së fundit, ka pasur një progres premtues mes aktorëve kryesorë në njohjen dhe integrimin e qasjeve gjinore në përpjekje për të promovuar sigurinë e gazetarëve. Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut po kërkojnë gjithmonë e më shumë qasje gjinore ndaj sigurisë së gazetarëve dhe tashmë ka gjithmonë e më shumë studime për çështjen e sulmeve ndaj gazetarëve. Kjo vëmendje në rritje po përfshin edhe ngacmimet dhe abuzimet me të cilat po përballen gjithmonë e më shumë gazetarët *online*. Në shkallë kombëtare, mund të shihet se organet mediatike dhe grupet e shoqërisë civile po investojnë më shumë energji në hartimin e programeve dhe mënyrave për adresimin dhe parandalimin nga ana e gazetarëve të ngacmimeve dhe abuzimeve gjinore *online*.

Megjithatë, nevojiten përpjekje edhe më të mëdha. Adresimi i ngacmimeve dhe abuzimeve gjinore *online*, si dhe i çështjes së dhunës ndaj gazetarëve në përgjithësi, duhet të përfshijë fushatat e ndërgjegjësimit publik për përmirësimin e normave sociale dhe barazisë në vendin e punës, duke garantuar në të njëjtën kohë që zërat e grave të dëgjohen edhe më shumë në të gjitha mediat, sidomos për çështje që njihen përgjithësisht si çështje që u takojnë burrave si për shembull, politika. Nevojitet një qasje e aktorëve të ndryshëm njëkohësisht që angazhohen në degë të ndryshme të qeverisë, organeve në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile nga të drejtat e njeriut, media dhe ofruesit e shërbimeve në internet. Është e rëndësishme që gratë gazetare, duke përfshirë edhe ato që kanë përjetuar sulme *online*, të përfshihen në hartimin e qasjeve dhe zgjidhjeve për adresimin e ngacmimeve dhe abuzimeve *online* ndaj gazetarëve. Sigurisht, çdo mbështetje që u jepet gazetarëve duhet të vijë me pëlqimin e tyre të shprehur qartë.

Udhëzuesi Burimor #SOFJO ka për qëllim të identifikojë rrugët konkrete për rritjen nga ana e aktorëve të ndryshëm të sigurisë së grave gazetare *online* duke marrë një qasje tërësore. Ky Udhëzues përbëhet nga dhjetë kapituj, ku secili i dedikohet një aktori të veçantë. Çdo kapitull do të japë një sërë rekomandimesh për masat që duhen marrë për adresimin e abuzimit dhe ngacmimit gjinor *online*, si dhe një sërë shembujsh të masave ekzistuese dhe një listë të burimeve të dobishme, me qëllim mbështetjen e aktorëve të ndryshëm në identifikimin e boshllëqeve të tyre, si dhe ofrimin e informacioneve plotësuese që mund të mbështesin krijimin ose përmirësimin e metodave ose nismave për adresimin e ngacmimeve dhe abuzimeve *online* ndaj gazetarëve.

Përmbajtja e kapitujve

Për aktorët shtetërorë, Udhëzuesi Burimor përcakton hapat dhe aspektet gjinore që duhet të merren parasysh nga ekzekutivi, legjislativi, gjyqësori dhe nga organet ligjzbatuese. Këto masa të propozuara përfshijnë analiza dhe reforma legjislative, hartimin e planeve kombëtare të veprimit, si dhe ndërtimin e dialogut. Ai propozon gjithashtu masa për integrimin e një qasjeje gjinore në të gjitha institucionet shtetërore, hetime dhe mekanizma të sigurisë së gazetarëve, si dhe ngritjen e programeve të zhvillimit të kapaciteteve për nëpunësit civilë. Një ndër pesë kapitujt e parë që mbulojnë aktorët shtetërorë do të trajtojë rolin e organeve ndërqeveritare, duke theksuar qasjet që mund të ndërmerren në përmirësimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe zbatimit të tyre efikas në shkallë kombëtare.

¹¹ Amnesty International, "Twitter toksik – Vend toksik për gratë", 2018, <https://www.amnesty.org/en/latest/research/2018/03/online-violence-against-women-chapter-1/#topanchor>.

¹² Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve, "Mbrojtja më e mirë; Kërcënimet ndaj sigurisë së gazetarëve kërkojnë qasje të re", 2017, <https://cpj.org/reports/2017/02/best-defense-threats-safety-journalists-freelance-emergencies-attack-digital/>.

¹³ Transparency International, "Kostot e larta që paguajnë gazetarët kur raportojnë për korrupsionin", 2020, <https://www.transparency.org/en/news/the-high-costs-journalists-pay-when-reporting-on-corruption#>.

¹⁴ Reporterët pa kufi, "Gazetarët: *bête noire* e krimit të organizuar", 2018, https://rsf.org/sites/default/files/en_rapport_mafia_ëeb_0.pdf.

¹⁵ Reporterët pa kufi, "Klimë armiqësore për gazetarët mjedisorë", 2015, https://rsf.org/sites/default/files/rapport_environnement_en.pdf.

¹⁶ Reporterët pa kufi, "Të drejtat e grave: temë e ndaluar", 2018, https://rsf.org/sites/default/files/womens_rights-forbidden_subject.pdf.

¹⁷ Ibid.

¹⁸ Përfshin të gjithë gazetarët që identifikohen si gra.

Udhëzuesi Burimor do të vazhdojë me pesë kapituj të tjerë që paraqesin hapat që rekomandohet të ndërmarrin aktorët joshitetorë: ndërmjetësit e internetit, organet mediatike, organizatat e gazetareve dhe aktorët që luajnë rol të rëndësishëm për vetërregullimin e pavarur; organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet e edukimit të gazetareve; si dhe gazetaret individualisht. Masat e rekomanduara përfshijnë: ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimit për përdorimin e rrugëve dixhitale dhe përvetësimin e njohurive ligjore; ngritjen e rrjeteve mbështetëse mes homologëve dhe burimeve të tjera psikosociale; forcimin e vlerësimit të riskut dhe protokolleve për raportimin dhe reagimin ndaj ngacmimeve *online*; fushatat për ndërgjegjësimin mbi pagat; si dhe avokimin për barazi në vendin e punës. Seksioni për aktorët joshitetorë do të përcaktojë gjithashtu edhe mënyrat për përmirësimin nga ana e aktorëve të ndryshëm të dokumentimit të sulmeve *online*. Nxitja e bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve të ndryshëm përbën një rekomandim që përshkon të gjithë Udhëzuesin.

Përveç kësaj, Udhëzuesi Burimor do të përfshijë edhe një seksion për standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që zbatohen për sigurinë e gazetarëve. Është e rëndësishme që në adresimin e ngacmimeve dhe abuzimeve gjinore *online* të respektohen të drejtat themelore të njeriut për lirinë e shprehjes dhe për privatësi.

Për Konferencën e Medias për Evropën Juglindore të këtij viti “Kufiri i Ri: Punojmë së Bashku për Nxitjen e Lirisë së Medias”, Zyra PLeM ka kënaqësinë të prezantojë tre kapituj të përzgjedhur para se Udhëzuesi Burimor #SOFJO të publikohet në tetor. Këta tre kapituj fokusohen në rolin e ekzekutivit, gjyqësorit dhe organeve ligjzbatuese. Ky udhëzues burimor dhe këta tre kapituj nuk pretendojnë të propozojnë një listë shteruese të masave që duhet të merren për të adresuar gamën e gjerë të ngacmimeve dhe abuzimeve online ndaj gazetarëve. Në fakt, ata i ofrojnë secilit prej tre aktorëve kryesorë një përzgjedhje të përmbledhur të hapave më të rëndësishëm dhe më të arritshëm. Për secilën masë të propozuar jepen shembuj konkretë të aktorëve të ndryshëm në vende të ndryshme. Kjo listë plotësohet nga një përzgjedhje e burimeve të dobishme.

Siguria e grave gazetare *online* nuk mund të adresohet e izoluar nga puna për sigurinë e të gjithë gazetarëve dhe as nuk mund të adresohet pa një përpjekje më të gjerë për barazi gjinore në shoqëri. Thënë më thjesht, siguria e grave në media mund të përmirësohet ndjeshëm nëse arrihen të drejta të barabarta për gratë dhe nëse ato kanë të njëjta mundësi dhe siguri si burrat. Po kështu, disa nga masat e propozuara përfshijnë edhe integrimin e një qasjeje gjinore në nismat ekzistuese që promovojnë sigurinë e gazetarëve. Masat e tjera kanë të bëjnë me përshkallëzimin apo përshtatjen e masave ekzistuese për barazi gjinore.

Qasja me ndjeshmëri gjinore

Çdo nismë që synon trajtimin e ngacmimeve dhe abuzimeve *online* ndaj gazetarëve duhet të strukturohet përmes një qasjeje me ndjeshmëri gjinore. Ndonëse qasja me ndjeshmëri gjinore ka të bëjë me ndërgjegjësimin për rolet, normat dhe marrëdhëniet gjinore, qasja me ndjeshmëri gjinore do të thotë që të merren parasysh normat gjinore, rolet dhe marrëdhëniet gjinore dhe mënyra se si politikatat apo masat e ndryshme ndikojnë në mënyra të ndryshme te burrat dhe gratë. Kjo qasje ka të bëjë me marrjen e masave që çojnë drejt barazisë gjinore.

Në këtë proces duhet të ndiqen këto 10 parime:

- 1. Neutraliteti gjinor nuk shihet gjini.** Çdo vendim apo masë, qoftë ligj, program trajnimi apo buxhet trajnimi, ose masa të ngjashme, kanë ndikime të ndryshme te njerëz të ndryshëm, duke përfshirë edhe ndikime që varen nga gjinia e tyre.
- 2. Gjinia ndërlihet me identitetet e tjera.** Gjinia së bashku me moshën, shtresën, të ardhurat, etninë, orientimin seksual, besimin fetar, aftësinë e kufizuar, racën dhe faktorë të tjerë, si për shembull të qenit pjesë e një kulture urbane apo një mjedisi rural, përbëjnë kategori të përkufizuara nga ana sociale, të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën dhe që çojnë në pabarazi që mund të mbivendosen dhe të varen nga njëra-tjetra. Kjo quhet qasje e ndërthurur dhe është e nevojshme, duke qenë pabarazinë e përjetojnë të gjithë njësoj.
- 3. Gatishmëri për transformim me integrim gjinor në çdo hap të procesit.** Pabarazitë mes grave dhe burrave, duke përfshirë aksesin asimetrik në kompetenca dhe të drejta, duhet të merren parasysh në të gjithë procesin, që nga hartimi, planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i legjislacionit, politikave dhe çdo mase tjetër.
- 4. Rëndësi ka edhe mënyra, jo vetëm përmbajtja.** Qasja me ndjeshmëri gjinore merr parasysh jo vetëm shkallën në të cilën gjinia dhe marrëdhëniet e pushtetit ndikojnë te konteksti. Kjo qasje përfshin edhe një proces gjithëpërfshirës, me pjesëmarrje dhe të respektueshëm që fuqizon dhe promovon barazinë gjinore.
- 5. Informacioni është kyç për gjetjen e zgjidhjeve.** Të dhënat e sakta dhe të plota për sulmet ndaj gazetarëve, të ndara sipas gjinisë dhe faktorëve të tjerë të ndërthurur, janë të nevojshme për të gjetur

rugëzgjdhje të forta dhe të përshtatura sipas konteksteve të ndryshme ekonomike, politike, kulturore dhe sociale.

6. **Të dëgjuarit e shumë zërave.** Për t'u siguruar se gratë gazetare janë ndër vendimmarrëset aktive në lidhje me punën që mund të ndikojë në jetën e tyre, nevojiten konsultime të gjera dhe transparente, që përfshijnë edhe aktorët qeveritarë dhe joqeveritarë në të gjitha specialitetet dhe fushat përkatëse të disiplinave.
7. **Ngritja e kapaciteteve për ndryshime.** Të gjithë aktorët e përfshirë në mbrojtjen e gazetarëve duhet të pajisen me trajnime mbi qasjet gjinore. Fokusi duhet të jetë së pari tek individët që kanë më shumë gjasa të ndikojnë dhe që kanë aftësinë për të sjellë ndryshime në mënyrë të gjerë dhe të qëndrueshme.
8. **Caktimi i burimeve të mjaftueshme.** Angazhimi për një qasje me ndjeshmëri gjinore duhet të shkojë përtej fjalëve, duke caktuar burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për zbatimin e këtyre masave.
9. **Të qenit SMART.** Nismat që adresojnë ngacmimet dhe abuzimet *online* ndaj gazetarëve duhet të kenë objektiva që janë Specifikë, të Arritshme, të Matshëm, Relevantë dhe me Afate Kohore. Kjo do të rriste llogaridhënien sa i përket barazisë gjinore dhe do të kontribuonte në futjen në sistem të mësimëve të nxjerra dhe në përmirësimin e masave në të ardhmen.
10. **Masat për mbrojtjen e grave duhet të çojnë përpara të drejtat e tyre themelore, jo t'i cenojnë ato.** Të gjitha masat që mund të kufizojnë të drejtën për lirinë e shprehjes duhet të parashikohen me ligj, të shërbejnë për qëllime legjitime dhe të jenë të nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike. Dekurajimi apo kufizimi i aktiviteteve profesionale të grave nuk përbën zgjidhje.

40 Masat e propozuara

Përtej tre kapitujve të përzgjedhur që do të paraqiten në Konferencën e Medias në Evropës Juglindore, Udhëzuesi Burimor

#SOFJO ofron disa masa të propozuara për 7 aktorë të tjerë kyçë me qëllim garantimin e një sigurie më të madhe *online* për gazetarët:

Pushteti ekzekutiv:

Zbatimi i politikave dhe praktikave për rritjen e sigurisë së gazetarëve

Masat e propozuara

1. Hartimi i një plani kombëtar veprimi për sigurinë e gazetarëve që adreson kushtet specifike të gazetarëve;
2. Marrja e masave mbrojtëse me ndjeshmëri gjinore;
3. Mbledhja e të dhënave për sulmet ndaj gazetarëve bazë për hartimin e politikave dhe studimeve, dhe fushatat ndërgjegjësuese për rritjen e angazhimit mes vendimmarrësve dhe publikut;
4. Raportimi mbi sigurinë e gazetarëve të mekanizmat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut, si dhe integrimi i kësaj çështjeje në politikat e jashtme.

Pushteti legjislativ:

Miratimi ose përshtatja e kuadreve ligjore për një mjedis më të sigurt *offline* dhe *online*

Masat e propozuara

1. Rishikimi dhe, sipas nevojës, ndryshimi dhe miratimi i ligjeve për promovimin e një qasjeje gjinore për sigurinë e gazetarëve;
2. Marrja e masave që legjislacioni që adreson ngacmimet dhe abuzimet *online* ndaj gazetarëve të mos cenojnë të drejtën për lirinë e shprehjes.

Gjyqësori:

Garantimi i aksesit në drejtësi dhe dhënia fund pandëshkueshmërisë

¹⁹ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Rezolutë 2200A (XXI), "Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike", 16 dhjetor 1966, në fuqi më 23 mars 1976, neni 19, <https://ëëë.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx>.

Masat e propozuara

1. Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet gjinore në të gjithë sistemin gjyqësor, si çështje thelbësore për mbrojtjen e gazetareve;
2. Rritja e ekspertizës mes personelit gjyqësor për çështjet e lirisë së shprehjes, sigurisë së gazetareve, ngacmimit dhe abuzimit *offline* dhe *online*;
3. Vënia në zbatim dhe promovimi i praktikave më të mira për aksesin në drejtësi, dënimet dhe mjetet juridike;
4. Institucionet kombëtare përgjegjëse për të drejtat e njeriut duhet të angazhohen me çështjen e sigurisë së gazetareve.

Agjencitë ligjzbatuese:

Forcimi i metodave për mbrojtjen dhe për hetime efektive

Masat e propozuara

1. Organizimi i më shumë trajnimeve për autoritetet ligjzbatuese mbi çështjen e sigurisë online të gazetareve, me qasje me ndjeshmëri gjinore;
2. Shqyrtimi dhe përmirësimi i aspekteve gjinore në vlerësimet e riskut të kërcënimeve dhe ngacmimeve;
3. Forcimi i protokolleve, metodave dhe procedurave për hetimin e krimeve ndaj gazetareve dhe për lirinë e shprehjes;
4. Rritja e dialogut dhe bashkërendimit për sigurinë e gazetareve mes autoriteteve ligjzbatuese, operatorëve mediatikë dhe shoqërisë civile.

Organizatat ndërqeveritare:

Nga përcaktimi i standardeve tek asistimi i Shteteve

Masat e propozuara

1. Integrimi i qasjeve gjinore në standardet dhe mekanizmat e të drejtave të njeriut për sigurinë e gazetareve;
2. Mbështetja e Shteteve për adresimin e boshllëqeve në zbatimin e standardeve ndërkombëtare në sigurinë e gazetareve;
3. Dhënia e ndihmës për rritjen e të dhënave dhe studimeve që mund të shërbejnë si bazë për hartimin e nismave për sigurinë e gazetareve *online*;
4. Priorizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të aktorëve për të prodhuar më shumë ndikim.

Ndërmjetësit në internet:

Respektimi i të drejtave të gazetareve dhe promovimi i sigurisë *online*

Masat e propozuara

1. Respektimi i standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për lirinë e shprehjes, privatësinë, pjesëmarrjen dhe mosdiskriminimin në politika dhe në praktikë;
2. Marrja e masave që politikat për moderimin e përmbajtjes të jenë të qarta, transparente dhe të aksesueshme për përdoruesit dhe që përdoruesit të jenë të vetëdijshëm si moderohet përmbajtja, çfarë përbën ngacmim dhe abuzim online, si dhe si raportohen ato;
3. Përdorimi i qasjeve me përdoruesin në qendër dhe jodiskriminuese në të gjitha proceset;
4. Trajtimi i kërkesave për heqje përmbajtjeje dhe për të dhënat e përdoruesve në mënyrë transparente dhe konsistente;
5. Promovimi i rolit të grave në gazetari.

Operatorët mediatikë: Mbrojtja e gazetareve fillon në punë

Masat e propozuara:

1. Përmirësimi i kulturës së punës me politika gjithëpërfshirëse si për sigurinë, ashtu dhe për gjininë;
2. Sigurimi i mbështetjes dhe trajnimit të gazetareve që përballen me ngacmime dhe abuzime online;
3. Hartimi i udhëzimeve të komunitetit me ndjeshmëri gjinore për platformat interaktive online;
4. Monitorimi dhe dokumentimi i abuzimeve dhe ngacmimeve online të gazetareve, përfshirë të gazetareve të pavarura (*freelancers*).

Masat e propozuara

1. Rritja e masave kolektive dhe avokimit për përmirësimin e sigurisë dhe kushteve të tjera të punës për gazetaret;
2. Forcimi i kapaciteteve përmes rrjeteve të profesionistëve, trajnimeve dhe mbështetjeve të tjera praktike;
3. Dokumentimi i sulmeve dhe përdorimi i informacionit për rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve kryesorë;
4. Nxitja e përfshirjes së çështjeve të sigurisë dhe barazisë gjinore më punën e organeve vetërregulluese.

Organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet arsimore:

Mobilizimi, studimet dhe shkëmbimi i praktikave të mira

Masat e propozuara

1. Rritja e të dhënave, njohurive dhe ndërgjegjësimit për ngacmimet dhe abuzimet gjinore *online* mes aktorëve kryesorë dhe shoqërisë në përgjithësi;
2. Bashkimi i forcave për çuarjen përpara të zbatimit të standardeve të sigurisë dhe kushteve të tjera të punës të gazetareve në nivel kombëtar;
3. Hartimi i materialeve tërësore trajnuese dhe edukuese për mbrojtjen e gazetarëve;
4. Integrimi i sigurisë dhe barazisë gjinore të gazetarëve në aktivitetet për edukimin dhe trajnimin e gazetarëve

Gazetarët dhe punonjësit e medias:

Prioritizimi i vetëmbrojtjes dhe mbështetjes mes kolegëve

Masat e propozuara

1. Monitorimi dhe vlerësimi i riskut për gazetaret;
2. Praktikimi i qasjeve tërësore ndaj sigurisë, duke përfshirë sigurinë ligjore, psikosociale dhe atë dixhitale;
3. Dokumentimi dhe raportimi i kërcënimeve dhe sulmeve;
4. Mbështetja e kolegëve që përballen me ngacmime dhe abuzime *online*, si dhe atyre që janë më të rrezikuar nga këto sulme;
5. Informimi për forma të ndryshme të mbështetjes, duke përfshirë edhe informimin për mekanizmat ligjorë.

2. Vështrim i tre kapitujve

A. Pushteti ekzekutiv:

Zbatimi i politikave dhe praktikave për rritjen e sigurisë së gazetareve

Ekzekutivi është përgjegjës për qeverisjen e Shteteve, duke hartuar politika dhe procese për ekzekutimin dhe zbatimin me efikasitet të ligjeve. Në këtë kapitull propozohen disa masa që mund të merren nga presidentët, kryeministritë dhe ministritë për mbrojtjen, por edhe për promovimin e sigurisë së gazetareve *online*. Ndonëse ky seksion nuk fokusohet te pushteti vendor, forma dhe funksionet e të cilave variojnë ndjeshëm, masat e propozuara mund të jenë njësoj të rëndësishme edhe për autoritetet vendore. Roli i agjencive ligjzbatuese, ndonëse është pjesë e përgjegjësive të ekzekutivit, adresohet më vete në kapitullin katër.

Vendimi nr. 3/18 i Këshillit Ministror të OSBE-së u bën thirrje Shteteve "të përmbushin plotësisht të gjitha angazhimet e ndërmarra në kuadër të OSBE-së dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare që lidhen me lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, duke përfshirë përmes respektimit, promovimit dhe mbrojtjes së lirisë për të kërkuar, për të marrë dhe për të dhënë informacione pavarësisht kufijve".

Masat e propozuara

1. Hartimi i një plani kombëtar veprimi për sigurinë e gazetarëve që adreson kushtet specifike për gazetaret;
2. Marrja e masave që janë me ndjeshmëri gjinore;
3. Mbledhja e të dhënave për sulmet ndaj gazetareve si bazë informimi për politikën dhe studimet, si dhe për fushatat e ndërgjegjësimit për rritjen e angazhimit mes vendimmarrësve dhe publikut;
4. Raportimi për sigurinë e gazetareve të mekanizmat kryesorë ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut, si dhe integrimi i këtyre çështjeve në politikën e jashtme.

1. Hartimi i një plani kombëtar veprimi për sigurinë e gazetarëve që adreson kushtet specifike për gazetaret femra

Angazhimet kombëtare për sigurinë e gazetareve duhet të demonstrohen në nivelet më të larta, si me fjalë, ashtu edhe me vepra. Anëtarët e qeverive duhet të dënojnë në mënyrë publike dhe pa ekuivok sulmet ndaj gazetareve në punën e tyre dhe jo thjesht rastet e dhunës fizike, por edhe kur janë raste që kanë të bëjnë me dhunën seksuale, frikësimin, kërcënimet dhe abuzime të tjera, duke përfshirë edhe kërcënimet mes teknologjive dixhitale. Zyrtarët publikë duhet të udhëheqin përmes shembullit të tyre dhe të mos denigrojnë, të mos frikësojnë dhe të mos kërcënojnë median duke përfshirë edhe përdorimin e gjuhës mizogjene ndaj gazetareve.

Dhuna ndaj gazetareve dhe ngacmimet dhe abuzimet *online* janë të lidhura ngushtësisht me pabarazitë më të gjera sociale dhe me qëndrimet ndaj grave. Politikën për adresimin e shkaqeve themelore të dhunës me baze gjinore dhe stereotipave gjinore duhet të shoqërojnë dhe të lidhen me planin e veprimit që ka për qëllim përmirësimin e sigurisë së gazetareve. Duhet të nxitet fuqizimi i grave në të gjithë shoqërinë dhe jo thjesht masat që janë specifike për sektorin e medias.

Sigurisht që ngacmimet dhe abuzimet online ndaj gazetareve lidhen me mjedisin mediatik, ku ato punojnë. Njohja e kontekstit specifik në secilin vend është thelbësor për adresimin e sigurisë së gazetarëve. Integrimi i një vlerësimi kombëtar për mënyrën sesi ekspozohen gratë dhe burrat gazetarë ndaj llojeve të ndryshme të kërcënimeve (fizike, psikologjike, dixhitale, ligjore dhe ekonomike) dhe ndikimi që këto kërcënime kanë tek ata janë një hap i parë i rëndësishëm në hartimin e një plani kombëtar për sigurinë e gazetarëve.

Qëllimi përfundimtar i një plani kombëtar veprimi duhet të jetë përcaktimi i masave më efektive për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për sigurinë e gazetarëve dhe për ta bërë këtë duke pasur ndërmend ndjeshmërinë ndaj përkatësisë gjinore. Kjo nënkupton hartimin e masave që adresojnë nevojat specifike të gazetareve, duke kontribuar në të njëjtën kohë për ndryshimin e dinamikave gjinore dhe atyre të pushtetit që cenojnë barazinë gjinore. Një hap konkret është kryerja e një auditimi me ndjeshmëri gjinore në lidhje

me zbatimin e standardeve dhe angazhimeve specifike, si për shembull për zbatimin e [Vendimit nr. 3/18 të Këshillit të Ministrave të OSBE-së për Sigurinë e Gazetarëve](#), si pjesë e një plani kombëtar veprimi për sigurinë e gazetarëve. Nëse ekziston një plan kombëtar veprimi që është aktiv lidhur me sigurinë e gazetarëve në vend, ky plan mund të rishikohet për integrimin në të të aspektit gjinor dhe për të përfshirë masa që adresojnë ngacmimet dhe abuzimet *online*, si programet dhe trajnimet mbi sigurinë për identifikimin dhe adresimin e ngacmimeve dhe abuzimeve online, si dhe për zhvillimin dhe forcimin e shoqatave, rrjeteve dhe forumeve mbështetëse për gratë gazetare, sidomos të atyre që punojnë kundër abuzimeve *online*.

Koordinimi edhe me fushat e tjera të rëndësishme të punës, si për shembull planet kombëtare të veprimit për barazinë gjinore, të drejtat e njeriut apo për kategori të tjera me mbivendosje temash janë gjithashtu një masë tjetër shumë e rekomandueshme.

Sipas [Planit të Veprimit të OKB-së për Sigurinë e Gazetarëve dhe Çështjen e Pandëshkueshmërisë](#), është thelbësore që të krijohen partneritete strategjike me aktorë të ndryshëm lokalë, rajonalë dhe ndërkombëtarë. Duke pasur këtë parasysh, masat për adresimin e ngacmimeve dhe abuzimeve online ndaj gazetarëve do të duhet të zhvillohen dhe zbatohen me një shkallë të lartë përfqësimit të grave gazetare. Në këtë mënyrë, praktikatat e përdorura do të ishin të mirinformuara nga personat e prekshëm nga ky problem dhe do t'i fuqizojnë ato në këtë mënyrë përmes pjesëmarrjes së tyre. Këtu mund të përfshihen të gjitha degët e shtetit; institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut; organet rregullatorë dhe vetërregullatore të medias; kompanitë e ndërmjetësimit në internet; organet mediatike publike, private dhe të komunitetit; shoqatat dhe unionet e gazetarëve; grupet e shoqërisë civile; institucionet e edukimit dhe gazetarisë dhe studiuesit akademikë; ekspertët e medias dhe organizatat e të drejtave të grave.

Shembuj

Integrimi i planeve kombëtare të veprimit: Plani kombëtar Suedez i veprimit [Mbrotjtja e Fjalës së Lirë: Masat për Mbrotjtjen e Gazetarëve, Përfqësuesve të Zgjedhur dhe Artistëve nga Ekspozimi ndaj Kërcënimeve dhe Urrejtjes](#) vlerëson nevojën e integritit të planit të sigurisë së gazetarëve në strategjinë gjinore kombëtare dhe nevojën për garantimin e një qasjeje gjinore nga aktorët kyçë, si për shembull nga gjyqësori. Një aspekt kryesor i këtij plani është zgjerimi, zhvillimi dhe financimi i institucioneve ekzistuese, si i qendrave lokale për mbështetjen e viktimave dhe linjave telefonike për mbështetjen e viktimave të kërcënimeve që raportohen përmes pjesëmarrjes në debatet publike.

Kryerja e auditimeve: Në vitin 2018, Universiteti i Amsterdimit zhvilloi një [Auditim për Lirinë e Fjalës në Holandë](#), për të dhënë një tablo konkrete të zbatimit të rekomandimit të vitit 2016 të Këshillit të Evropës për mbrotjtjen e gazetarisë, sigurinë e gazetarëve dhe të aktorëve të tjerë mediatikë në Holandë. Edhe pse ky auditim nuk përfshin në mënyrë specifike çështjen e dhunës online ndaj gazetarëve, ai përbën një shembull të mirë të mënyrës se si mund të kryhen vlerësime të tilla efikase.

Përfshirja e mbrotjtjes së gazetarëve në politika: Për rritjen e ndikimit, mbrotjtja e gazetarëve mund të përfshihet në politikat kombëtare për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut ose në politika të tjera që lidhen me to. [Programi Kombëtar për Mbrotjtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut për Periudhën 2013 – 2016](#) në Kroaci, për shembull, përfshinte një rekomandim për forcimin e ndjekjes penale të autorëve të kërcënimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve.

Burimet

- [Treguesit e UNESCO-s për Sigurinë e Gazetarëve](#) (JSI) ofrojnë një sërë treguesish për të vlerësuar gjendjen e sigurisë së gazetarëve në nivel kombëtar. Këta tregues përfshijnë edhe një udhëzues për mënyrën e zbatimit të tyre ndonëse zbatimi i tyre duhet të plotësohet me një instrument për vlerësimin me ndjeshmëri gjinore. Treguesit JSI janë aplikuar në Afganistan, Guatemala, Irak, Kenia, Nepal dhe Pakistan dhe raportet e tyre mund të konsultohen në [faqen e internetit të JSI të UNESCO-s](#).
- [Manuali i UN Women për Planet Kombëtare të Veprimit për Dhunën Ndaj Grave](#) mund të shërbejë si një pikë referimi për integrimin e qasjes gjinore në planet e veprimit për sigurinë e gazetarëve. Gjithashtu, udhëzimet e UN Women [Si të Menaxhojmë Vlerësimet me Ndjeshmëri Gjinore](#) mund të ofrojnë disa këshilla për vlerësimin e sigurisë së gazetarëve me një qasje gjinore.

2. Marrja e masave mbrotjtëse me ndjeshmëri gjinore

Gazetarët që kërcënohen duhet të kenë akses të menjëhershëm në masa konkrete mbrotjtëse. Reagimi i shpejtë ndaj kërcënimeve ndaj gazetarëve mund të jetë efikas në mbrotjtjen e viktimave (potenciale) dhe në minimizimin e përshkallëzimeve të mundshme të dhunës. Ky lloj mekanizmi mund të jetë pjesë e mbikëqyrjes së një organi qeveritar, si për shembull pjesë e mbikëqyrjes së një agjencie ligjzbatuese apo të një grupi me shumë aktorë dhe

që është i ngarkuar për zbatimin e një mekanizmi kombëtar mbrojtjeje. Ndonëse këta mekanizma përdoren tradicionalisht në rastet e sulmeve fizike, ata mund të mobilizohen edhe për mbështetje ligjore dhe psikologjike, duke përfshirë edhe rastet e ngacmimeve dhe abuzimeve *online*.

Duke pasur parasysh natyrën e veçantë dhe shpesh delikate të kërcënimeve ndaj gazetarëve, ku mund të përfshihet edhe dhuna seksuale, kërcënimet për dhunë dhe sulmet seksuale, duke përfshirë edhe sulmet ndaj familjarëve, është e domosdoshme që të gjitha masat, duke përfshirë edhe ato që ndërmerren nga mekanizmat e reagimit të shpejtë, të jenë të ndjeshme në aspektin gjinor. Një hap i parë për ta garantuar këtë është çfarëdolloj analizimi i sulmeve të bëra të marrë parasysh çdo aspekt gjinor dhe që gratë të kenë ku të drejtohen në rast nevojash për siguri, duke marrë masat që në organe të ndryshme të ketë punonjëse gra, si për shembull oficerë gra ligjzbatuese për mbrojtjen e personave të sulmuar, duke përfshirë oficeret shoqëruuese apo punonjëset që u përgjigjen telefonatave të bëra në linjat telefonike në raste emergjencash. Në protokollet për vlerësimin dhe reagimet ndaj riskut duhet të merren parasysh masat që duhen marrë, për shembull, në rastin e zhvendosjeve të nevojshme, përshtatur sipas nevojave specifike të grave të sulmuara.

Është e rëndësishme që në çdo reagim të shpejtë dhe në çdo mekanizëm mbrojtjeje të ketë masa parandaluese dhe zgjidhje proaktive dhe jo vetëm elementë reagues. Këtu mund të përfshihet një sistem për monitorimin e risqeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve *offline* dhe *online*, kombinuar me një analizë gjinore. Këto masa parandaluese janë vendimtare për identifikimin e tendencave dhe për garantimin e gatishmërisë për adresimin e kërcënimeve në mënyrë më efektive. Nismat parandaluese mund të përfshijnë edhe programet e trajnimit për të gjithë aktorët e përfshirë në proces, duke përfshirë edhe trajnime mbi mënyrën se si reagohet kur gazetarët kthehen në shënjestra të ngacmimeve dhe abuzimeve *online*, si dhe krijimi i burimeve lehtësisht të aksesueshme për informimin e gazetarëve se si t'i përdorin këto mekanizma dhe çfarë masash ekzistojnë. Këto përpjekje duhet të shoqërohen me fushata informuese.

Masat mbrojtëse janë më të aksesueshme dhe më efektive kur ato përshtaten sipas rastit dhe kontekstit të çdo gazetari. Për shembull, kjo do të thotë që pajisjet mbrojtëse duhet të përshtaten sipas trupit dhe veshjes së gazetarëve, që mbështetja financiare mund të duhet të mbulojë edhe personat që varen nga gazetaret, si dhe mbështetjen psikologjike specifike që duhet të garantohet për gazetaret që ngacmohen apo abuzohen *online*. Të gjithë aktorët e përfshirë në mbrojtjen e gazetarëve duhet të trajnohen për qasjet me ndjeshmëri gjinore.

Strukturimi i mekanizmave dhe masave mbrojtëse për përfshirjen e përfaqësimit të shumë aktorëve në menaxhim dhe mbikëqyrje çon në bashkimin e ekspertizave të ndryshme në tavolinë, si dhe në një llogaridhënie më të madhe. Mes këtyre grupeve të aktorëve të përfshirë në proces duhet të jenë dhe organizatat për të drejtat e grave dhe të drejtat e gazetarëve.

Përpjekjet për përmirësimin e sigurisë së gazetarëve duhet të shoqërohen gjithmonë me ndjekjen penale të dhunës ndaj gazetarëve dhe me adresimin e pandëshkueshmërisë për krimet ndaj gazetarëve. Si masë konkrete për të luftuar këtë tendencë, ekzekutivi mund të caktojë një prokuror kombëtar të pavarur të specializuar për krimet ndaj fjalës dhe gazetarëve, sa herë që është nevoja. Ky prokuror i posaçëm mund të mbikëqyrë dhe të koordinojë çështjet e ndryshme; të ofrojë mbështetje për viktimat; të promovojë një kulturë të tolerancës zero ndaj pandëshkueshmërisë për krimet ndaj lirisë së shprehjes dhe ndaj gazetarëve. Ky person duhet të trajnohet për të pasur disa qasje me ndjeshmëri gjinore.

Në disa vende, mund të ketë tashmë mekanizma funksionale kombëtare për të ofruar mbrojtje dhe reagime të shpejta. Duke qenë se sulmet me bazë gjinore, përfshirë edhe ngacmimet dhe abuzimet online janë kthyer në një lloj ngacmimi madhor relativisht kohët e fundit mund të jetë e nevojshme që të rishikohen dhe të reformohen mekanizmat ekzistues për të garantuar një qasje me ndjeshmëri gjinore. Ky proces duhet të kryhet në konsultim me aktorë të tjerë, duke përfshirë edhe ekspertët për perspektivën gjinore të politikave publike dhe në dhënien e ndihmës për garantimin e sigurisë.

Shembuj

Ngritja e mekanizmave kombëtare të reagimit të shpejtë: [Ufficio Centrale Interforze per la Sicurezza Personale](#), organ brenda Ministrisë së Brendshme në Itali, udhëheq një mekanizëm reagimi të shpejtë duke ofruar truproja, automjete të blinduara dhe pajisje të tjera mbrojtëse për gazetarët e kërcënuar prej krimit të organizuar.¹

Ngritja e grupeve shumëpalëshe: Holanda ka krijuar [Grupin Drejtues për Agresionin dhe Dhunën ndaj Gazetarëve](#), me pjesëmarrjen e shumë palëve, me tagrin që të koordinojë përgjigjen kundër sulmeve ndaj gazetarëve, duke përfshirë policinë, prokurorinë, sektorin e medias dhe gazetarët.²

Nxitja e komisioneve hetimore: Ministria e Brendshme e Serbisë bashkë me autoritetin e sigurisë kombëtare dhe shoqatën e gazetarëve drejton një Komision për Hetimin e Vrasjeve të Gazetarëve gjatë Luftës në Ish-

Jugosllavi, i ngritur në vitin 2013. Si rezultat, një person u dënua për vrasje e një gazetari serb në vitin 1999. Edhe pse fokusi i tij nuk është te abuzimi dhe ngacmimi *online* ndaj gazetarëve, ky është një shembull i mirëse si mund të bashkohet ekspertiza e shumë palëve dhe të përforcohet mbikëqyrja.

Mbështetja për mekanizmat rajonalë të reagimit të shpejtë: Në vitin 2020, Bashkimi Evropian (BE) mbështeti krijimin e mekanizmit [Reagimi i Shpejtë për Lirinë e Medias](#) për të mbrojtur gazetarët, që drejtohet përditë nga një grup i shoqërisë civile. Ekzistonte ndërkohë një mekanizëm reagimi të shpejtë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, [ProtectDefenders.eu](#), që ka në përbërje gazetarë. Ky mekanizëm drejtohet nga një bashkim OJF-sh të të drejtave të njeriut.

Ngritja e mekanizmave të mbrojtjes kombëtare: Kolumbia ishte i pari vend në botë që ngriti një mekanizëm të mbrojtjes kombëtare për gazetarët. Mekanizmi përfshin një komitet për mbrojtjen e grave, me përfaqësuese nga organizatat e të drejtave të grave, qeveria dhe organizatat ndërkombëtare si UN Women. Ato analizojnë çdo rast që marrin nga perspektiva gjinore, që u ka mundësuar përgjigje të individualizuara. 12 vjet pas themelimit të programit të mbrojtjes në vitin 2000, qeveria miratoi një protokoll në vitin 2012 që adreson kërcënimet ndaj gazetarëve: një shembull i mirë ky për rivlerësimin dhe reformimin e mekanizmit ekzistues me qëllimin për të integruar qasjen me ndjeshmëri gjinore.

Caktimi i prokurorëve të posaçëm: Në vitin 2006, Meksika caktoi të parin prokuror të posaçëm për krimet ndaj lirisë së shprehjes, me fokus të veçantë të sulmet ndaj gazetarëve.

Burimet

- [Raporti 24/2 i Këshillit të Të Drejtave të Njeriut \(HRC\) të OKB-së ka mbledhur praktikat e mira](#) të aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë për sigurinë e gazetarëve.
- Këshilli i Evropës ka publikuar një sërë rekomandimesh dhe praktikash të mira për sigurinë e gazetarëve, si [Marrja e Masave për të Mbrojtur Gazetarët dhe Aktorët e tjerë të Medias](#) që përmban shembuj konkretë se si disa shtete kanë zbatuar standardet e Këshillit të Evropës për sigurinë e gazetarëve.
- Një koleksion me mekanizma për mbrojtjen e gazetarëve mund të gjendet në serinë e publikimeve për Mbështetjen Ndërkombëtare të Medias në [Mbrojtja e Gazetarisë](#); ku një [publikim](#) i kushtohet posaçërisht sigurisë së gazetarëve.
- Nisma Reagimi i Shpejtë për Lirinë e Medias publikoi një koleksion me masa mbrojtëse që janë marrë Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet candidate.
- Universiteti i Palermos ka analizuar efektivitetin dhe strukturën institucionale për mekanizmat e mbrojtjes, në një raport për rastet në Kolumbi, Meksikë dhe Guatemalë.

3. Mbledhja e të dhënave për sulmet ndaj gazetarëve si bazë informimi për politikat dhe studimet, si dhe për fushatat e ndërgjegjësimin për rritjen e angazhimit mes vendimmarrësve dhe publikut

Përgjigjet e fuqishme ndaj abuzimit dhe ngacmimit *online* të gazetarëve mund të hartohen vetëm nëse politikëbërësit, profesionistët e medias, grupet e shoqërisë civile dhe publiku i gjerë kanë një panoramë të qartë për shtrirjen e problemit dhe ndikimin e tij te profesioni i gazetarit, liria e shprehjes dhe qarkullimi i lirë i informacionit. Për të krijuar këtë panoramë, ka nevojë për mbledhje të dhënash sasiore dhe cilësore, analiza dhe studime.

Si fillim, duhet të mblidhen të dhëna të agreguara sipas gjinisë, por edhe sipas identiteteve të tjera ndërseksionale. Këto të dhëna nevojiten për të garantuar që zgjidhjet të kenë parasysh kompleksitetin dhe diversitetin e mënyrave se si dhuna prek grave dhe se si dhuna strukturore ushtrohet ndaj grupeve të caktuara në shoqëri.

Disa fusha kyçe të kërkimeve dhe studimeve përfshijnë mbledhjen e të dhënave që bëjnë dallimin mes formave të ndryshme të abuzimit *online*, shkallën e sulmeve *online* si edhe ndikimin që ka te të drejtat dhe puna e gazetarëve. Identifikimi i pengesave dhe rreziqeve gjinore, si edhe të kuptuarit se si këto ndryshojnë nga ato me të cilat përballen meshkujt, do të shërbente për politikat me bazë evidence dhe reagimet e tjera të mundshme.

Më e mira është që të dhënat të mblidhen në bashkëpunim me organet kombëtare të statistikave, universitetet, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe grupet e shoqërisë civile, për të garantuar informacionin më të saktë dhe të pavarur, si edhe të drejtën e privatësisë. Mbledhja e të dhënave, përveç se shërben për masat/politikat kombëtare, është e dobishme edhe për të informuar mekanizmat ndërkombëtarë. Treguesi 16.10.1. i Vlerësimeve Kombëtare Vullnetare (VNR) i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ), për shembull, u kërkon autoriteteve që të raportojnë numrin e sulmeve ndaj gazetarëve në vendin e tyre.

Mbledhja e të dhënave mund të mbështetë edhe fushatat e fuqishme ndërgjegjësuëse, duke treguar se abuzimi dhe ngacmimi *online* nuk është sulm vetëm ndaj gazetarëve, por edhe ndaj lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias, si edhe një kërcënim për të drejtën e çdo personi që të ketë akses në informacion në shoqëri si e tërë.

Puna arsimore është një tjetër hap i rëndësishëm për të bërë publikun të kuptojë më mirë këtë problematikë. Autoritetet arsimore mund të integrojnë përdorimin dhe tendencat e medias sociale në programet mësimore, ose t'i përfshijnë në programet e edukimit për median. Për shembull, mund të hartohen dhe të vihen në zbatim programe arsimore joformale për të rriturit që promovojnë një shoqëri të edukuar për median dhe botën dixhitale. Kjo qasje mund të kontribuojë për një mjedis më të sigurt për qytetarët që marrin pjesë në median sociale, përfshirë gazetaret.

Si pjesë e strategjisë së ndërgjegjësimit publik, zyrtarët shtetërorë mund të bëjnë deklarata publike, qoftë edhe me postime në median sociale sipas rastit, që të shprehin mbështetjen për gazetarët e shënjestruar, si edhe të organizojnë aktivitete për sensibilizimin e qytetarëve për rolin e gazetarisë dhe ndikimin negativ që kanë të shoqëria sulmet ndaj gazetarëve. Ditët ndërkombëtare përkujtimore, si Dita Botërore e Lirisë së Shtypit (3 maj), Dita Ndërkombëtare për T'i Dhënë Fund Pandëshkueshmërisë për Krimet ndaj Gazetarëve (2 nëntor), Dita Ndërkombëtare e Gruas (8 mars) dhe Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (25 nëntor) janë mundësi të mira për nisma të tilla.

Shembuj

Krijimi i paneleve me ekspertë ligjorë: Mbretëria e Bashkuar ka krijuar një [Panel të Nivelit të Lartë me Ekspertë Ligjorë](#), si strukturë e pavarur me qëllimin që të bëjë studime për të informuar mbi zhvillimet e legjislacionit dhe politikave lidhur me sigurinë e gazetarëve. Raporti i parë i publikuar në shkurt 2020 fokusohet te [Përdorimi i Sanksioneve të Shënjestruara Për Të Mbrojtur Gazetarët](#).

Hartimi i programeve për edukimin e medias: Një raport i përgatitur nga ekspertët kombëtarë për Observatorin Audioviziv që t'i dorëzohet Komisionit Evropian i referohet [547 projekteve për edukimin e medias](#) të zbatuara në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian që nga viti 2010. 403 prej këtyre projekteve fokusoheshin te aftësitë për edukimin e medias lidhur me mendimin kritik, ndërsa projektet me fokus kapacitetet e përdorimit të medias ishin 385 nga 547.

Finlanda ka një politikë kombëtare që u adresohet institucioneve arsimore formale dhe joformale, medias dhe aktorëve të tjerë përkatës, që të promovojnë informimin për median *offline* dhe *online* si dhe mjedisin e medias sociale.

4. Raportimi për sigurinë e gazetarëve te mekanizmat kryesorë ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut, si dhe integrimi i këtyre çështjeve në politikat e jashtme

Përmes pjesëmarrjes në organizatat ndërqeveritare (ONQ), Shtetet mund të luajnë rol konstruktiv duke kontribuar në zhvillimin e standardeve ndërkombëtare për sigurinë e gazetarëve. Shtetet duhet të japin sugjerime edhe për çështjen e sigurisë së gazetarëve dhe për një qasje më të fortë me ndjeshmëri gjinore në shumë prej rezolutave, rekomandimeve dhe vendimeve që miratojnë ONQ-të.

Shtetet mundet të kontribuojnë aktivisht dhe të angazhohem me organet e traktateve ndërkombëtare me fokus barazinë gjinore, si p.sh. Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, apo Komisioni i OKB-së për Statusin e Grave (CSW). Ndër të tjera, CSW-ja monitoron ecurinë e zbatimit të Deklaratës së Pekinit dhe të Platformës për Veprim, që njih rëndësinë e promovimit të grave në industrinë e medias dhe integritet të perspektivës gjinore në përmbajtjen e medias.

Një zotim i rëndësishëm llogaridhënieje që Shtetet kanë lidhur me standardet ndërkombëtare është edhe detyrimi i tyre për të raportuar zbatimin. Raportimi i konsoliduar siguron matjen e ecurisë përkundër objektivave apo detyrimeve, por shërben edhe si mjet për të dokumentuar tendencat dhe praktikat e mira, por edhe nivelet e pandëshkueshmërisë. Shtetet mund të përmirësojnë më tej cilësinë dhe sasinë e kontributeve të tyre lidhur me dhunën ndaj gazetarëve (në bashkëpunim me aktorët joshtetërorë që mbledhin të dhëna dhe përgatisin studime) kur marrin pjesë në mekanizmat e mëposhtëm:

- [Rishikimi Periodik Universal \(UPR\)](#)-i OKB-së. Në kuadrin e këtij procesi, Shtetet duhet të raportojnë për situatën e të drejtave të njeriut në vendin e tyre, pastaj, anëtarët e Këshillit të Të Drejtave të Njeriut (HRC) të OKB-së japin rekomandime për përmirësim. Ky proces është mundësi e shkëlqyer për ta bërë sigurinë *online* dhe *offline* të gazetarëve një prioritet në të gjitha Shtetet.

- Shtetet mund të nënvizojnë edhe sfidat me të cilat përballen gazetaret, kur raportojnë për [raportet](#) periodike që publikon HRC-ja dhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së për Zbatimin e rezolutave për sigurinë e gazetarëve që miratojnë HRC-ja dhe Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (UNGA).-
- E njëjta vlen edhe për [raportet tematike, komunikatat dhe apelet urgjente](#) nga Procedurat e Posaçme të HCR-së, sidomos nga Relatori i Posaçëm për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës për lirinë e mendimit dhe shprehjes, si edhe nga institucione të tjera funksionet e të cilave përfshijnë dhunën ndaj gazetarëve.-
- Në [Vlerësimet Kombëtare Vullnetare](#) për zbatimin e OZhQ-ve dhe sidomos për OZhQ 5 (barazia gjinore dhe fuqizimi i grave) dhe për OZhQ 16 (promovimi i shoqërive të drejta, paqësore dhe gjithëpërfshirëse), Shtetet duhet të paraqesin të dhëna për sigurinë e gazetarëve të agreguara sipas gjinisë.-
- Në përgjigje të kërkesave për informacion të UNESCO-s për ecurinë gjyqësore të çështjeve për vrasjen e gazetarëve, [Raporti i Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s për Sigurinë e Gazetarëve dhe Rrezikun e Pandëshkueshmërisë](#) lejon organizatën e OKB-së të mandatuar për mbrojtjen e lirisë së shprehjes që të monitorojë tendencat që prekin sigurinë e gazetarëve. Gjithashtu, UNESCO mbledh një gamë të gjerë kontributesh për [Raportin e Tendencave Botërore](#) për lirinë e shprehjes dhe zhvillimin e medias, i cili përfshin informacion për ngacmimin *online* ndaj gazetarëve. Përveç se të japin të dhëna, Shtetet mund të ndihmojnë në promovimin e gjetjeve të këtyre raporteve.
- Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës duhet t'u përgjigjen paralajmërimeve që shfaqen në [Platformën e Këshillit të Evropës Për Të Promovuar Mbrojtjen e Gazetarisë dhe Sigurisë së Gazetarëve](#). Platforma monitoron veçanërisht incidentet ku përshihen gazetarë dhe u kërkon përgjigje Shteteve.-
- Nismat shumëpalëshe, si p.sh. [Partneriteti i Qeverisë së Hapur](#), [Koalicioni i Lirisë Online](#), [Komuniteti i Demokracive](#) dhe [Koalicioni i Lirisë së Medias](#), mund të shërbejnë si forume të mira për të promovuar diskutimet mbi politikën që adresojnë sigurinë e grave gazetare *online*.

Përveç këtyre mekanizmave ndërkombëtarë, mund të mobilizohen edhe përfaqësitë diplomatike në shtete të tjera për të promovuar aktivitete publike, për të dalë me deklaratat publike si edhe për të mbështetur nismat rajonale dhe vendore që promovojnë sigurinë e gazetarëve. Lehtësimi i kërkesave për viza dhe azil për gazetaret e kërcënuara mund të jetë një tjetër përgjigje jetike për to.

Shembuj

Inkorporimi i SOFJO-s në Rishikimet Periodike Universale (UPR): Në shtator 2019, pasi 84 Shtete kishin kaluar procesin UPR, 43 prej tyre e inkorporuan çështjen e sigurisë së gazetarëve në rekomandimet e tyre. Kirgistani, Mali i Zi, Federata Ruse dhe Turkmenistani ishin mes Shteteve pjesëmarrësve të OSBE-së që morën rekomandime për sigurinë e gazetarëve. Ndër Shtetet që ishin zë të fortë për këtë çështje përmendim Republikën Çeke si më aktive, e ndjekur nga Austria, Kanadaja, Franca, Lituania dhe Norvegjia. Sllovenia, për shembull, rekomandoi që Meksika të integrojë perspektivën gjinore kur adreson sigurinë e gazetarëve.

Grupet informale ndërqeveritare: Disa Shtete, në cilësinë e tyre si anëtare apo pjesëmarrëse në nisma ndërqeveritare, kanë krijuar grupe informale për sigurinë e gazetarëve. Qëllimi i tyre është të punojnë bashkë për të shtuar vëmendjen ndaj kësaj çështjeje. Grupe të tilla informale për bashkëpunim ekzistojnë në OKB në Gjenevë dhe në Nju Jork, UNESCO dhe OSBE. Përveç se koordinojnë përpjekjet në kuadrin e rezolutave dhe masave të tjera politike, këto grupe organizojnë aktivitete për të sjellë këtë çështje në vëmendje. Për shembull, në vitin 2019, Grupi i Miqve të UNESCO-s për sigurinë e gazetarëve organizoi një konferencë për ngacmimin *online* ndaj gazetarëve. Po atë vit, Grupi i Miqve të OKB-së në Nju Jork organizoi një aktivitet për sigurinë e gazetarëve dhe OZhQ-të.

Dhënia e deklaratave mbi politikën: Në [2018](#) dhe [2019](#), grupi informal i miqve të OSBE-së për sigurinë e gazetarëve doli me deklaratat që shprehnin shqetësimin për dhunën ndaj gazetarëve.-

Burimet

- Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për Të Drejtat e Njeriut ka një [databazë](#) me rekomandime për të drejtat e njeriut që janë dhënë nga sistemi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut të OKB-së, që është një burim i çmuar për të hartuar politikën publike.-
- Raporti i ARTICLE 19 [Dhënia Fund Pandëshkueshmërisë: Veprimi për Standardet OKB-së dhe Sigurinë e Gazetarëve](#) përmbledh standardet më të fundit për sigurinë e gazetarëve, dhe rekomandime për adresimin e dhunës ndaj gazetarëve *online* dhe *offline*. Raporti ka një kapitull për qasjet me ndjeshmëri gjinore ndaj sigurisë së gazetarëve.
- Koalicioni i Shteteve pjesëmarrëse në Partneritetin e Qeverisë së Hapur hartoi një raport global për [Hapësirën Qytetare: Mbrojtja e Aktivistëve dhe Gazetarëve](#), që përmban praktika të mira të miratuara nga Shtetet për sigurinë e gazetarëve.-
- Përmes nismës [Media4Democracy](#) [Media për Demokracinë], BE-ja ka mbështetur delegacionet e BE-së në mbarë botën që të kuptojnë më mirë sfidat e lirisë së medias dhe të forcojnë lirinë e shprehjes. Kjo përfshin

Manualin për Delegacionet e BE-së: Mbrojtja e Sigurisë së Gazetarëve, Mbrojtja e Lirisë së Shprehjes që ofron orientime teknike për t'u pasur parasysh gjatë marrjes së masave për sigurinë e gazetarëve.

- Komuniteti i Demokracive publikoi [Manualin për Sigurinë e Gazetarëve për Personelin e Misioneve Diplomatike](#), që përmban masa konkrete për të promovuar sigurinë e gazetarëve, si p.sh. mbajtja e një dialogu periodik me autoritetet dhe gazetarët; dhënia e mbështetjes në rast emergjencash; monitorimi i gjyqeve ndaj gazetarëve apo dhunuesve të tyre; dhe lehtësimi i dokumenteve të udhëtimit dhe vizave.
- Komiteti për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme i Parlamentit Evropian publikoi udhëzuesin [Siguria e Gazetarëve dhe Lufta ndaj Korrupsionit në BE](#) që eksploron masa të ndryshme rregullatore dhe të tjera për t'u kundërvënë sulmeve ndaj gazetarëve në Bashkimin Evropian.

¹ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Këshilli Ministror, Vendimi Nr. 3/18, "Siguria e gazetarëve", 7 dhjetor 2018, Milano, <https://www.osce.org/chairmanship/406538?doenload=true>.

² Ibid.

³ Elisabeth Witchel, Përgjegjësia e përbashkët: Ruajtja e lirisë së shtypit në kohë të rrezikshme, (IMS: Kopenhagen, 2020), <https://www.mediasupport.org/publication/shared-responsibility-safeguarding-press-freedom-in-perilous-times/>

⁴ "Plani i Veprimit i OKB-së për Sigurinë e Gazetarëve dhe Çështjen e Pandëshkueshmërisë", (CI-12/CONF.202/6) UNESCO, <https://en.unesco.org/un-plan-action-safety-journalists>.

⁵ "Mbrojtja e lirisë së shprehjes – masat për mbrojtjen e gazetarëve, përfaqësuesve të zgjedhur dhe artistëve nga ekspozimi ndaj kërcënimeve dhe urrejtjes", Qeveria e Suedisë, Ministria e Kulturës, 2018,

<https://eëë.government.se/4990f9/contentassets/bd181f7b0f4640e7920807d110b3c001/action-plan-defending-free-speech.pdf>; Pika e kontaktit në ndihmë të gazetarëve në Institutin e Medias Fojo: <https://fojo.se/verktyg-for-journalister/demokratijouren/hjelpdesk/>.

⁶ "Auditimi i lirisë së shprehjes në Holandë", Universiteti i Amsterdimit, Instituti për Ligjin e Informimit, <https://eëë.ivir.nl/projects/auditoffreedomofexpression/>.

⁷ Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave për Shtetet Anëtare, "Rekomandimi Nr. 4 për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias", miratuar më 13 prill 2016, https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset_publisher/aDXmrol0vvsU/content/recommendation-cm-rec-2016-4-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-the-protection-of-journalism-and-safety-of-journalists-and-other-media-.

⁸ "Dhuna, kërcënimet dhe presionet ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias në BE." (Kontributi në Kolokiumin e dytë Vjetor për të Drejtat Themelore – Nëntor 2016), Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore,

https://ec.europa.eu/information_society/newsroom/image/document/2016-47/fra_threats_and_pressures_paper_19751.pdf.

⁹ "Treguesit e Sigurisë së Gazetarëve: Niveli kombëtar; bazuar në Treguesit e Zhvillimit të Medias të UNESCO-s", UNESCO, 2015, <https://en.unesco.org/themes/safety-of-journalists/journalists-safety-indicators>.

¹⁰ UNESCO, *Aplikimi i Treguesve të Sigurisë së Gazetarëve të UNESCO-s (JSI): Udhëzues praktik në ndihmë të studiuesve*, (Paris: UNESCO, 2015), <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000260894>.

¹¹ UN Women, *Udhëzues për Planin Kombëtar të Veprimit për Dhunën ndaj Grave*, (Nju Jork: UN Women, 2012), <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2012/7/handbooknationalactionplansonvaw-en%20pdf.pdf?la=en&vs=1502>.

¹² UN Women, *Si menaxhohet vlerësimi me ndjeshmëri gjinore*, (Nju Jork: Zyra e UN Women për Vlerësimin e Pavarur, 2015), <https://genderevaluation.unwomen.org/-/media/files/un%20ëomen/gender%20evaluation/handbook/evaluationhandbook-ëeb-final-30apr2015.pdf?la=en&vs=4246>.

¹³ *Deklaratë e Përbashkët për Krimet ndaj Lirisë së Shprehjes*, Raportuesi i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara për Lirinë e Opinionit dhe Shprehjes, Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias, Raportuesi i Posaçëm i Organizatës së Shteteve Amerikane për Lirinë e Shprehjes dhe Komisioni Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve (ACHPR), Raportuesi i Posaçëm për Lirinë e Shprehjes dhe Aksesin në Informacion, paraqitur më 25 qershor 2012, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/91595>.

¹⁴ Alberto Spampinato, *Italia, Kaq shumë Mafie, Kaq Pak Lajme*, Qendra Evropiane për Median dhe Lirinë si dhe Osservatorio Balconi e Caucaso, 2018, <https://adobeindd.com/view/publications/4fd5ff1c-0f8c-4186-9565-dd3217e63b28/bndf/publication-web-resources/pdf/ECPMF-FFM-Italy.pdf>.

¹⁵ Presveilig, <https://www.persveilig.nl/>.

¹⁶ Reagimi i Shpejtë i Lirisë së Medias, <https://www.mfrr.eu/>.

¹⁷ Unidad Nacional de Protección, <https://www.unp.gov.co/>.

¹⁸ "Conoce a la Fiscalía Especial para la Atención de Delitos cometidos contra la Libertad de Expresión", Fiscalía General de la República, 2019, <https://www.gob.mx/fgr/documentos/conoce-a-la-fiscalia-especial-para-la-atencion-de-delitos-cometidos-contra-la-libertad-de-expresion>.

¹⁹ Te ai dokument, fundshënimi 5.

²⁰ Peter Noorlander, *Marrja e Masave për të Mbrojtur Gazetarët dhe Aktorët e Tjerë të Medias*. "Inteligjenca Artificiale– Sfidat e Politikës Inteligjente dhe mundësitë për median dhe demokracinë", Konferenca Ministrorë, 28-29 maj 2020, Qipro, <https://rm.coe.int/cyprus-2020-safety-of-journalists/168097fa83>.

²¹ "Praktikat më të mira globale nga studimet e reja për sigurinë e gazetarëve", lajm nga IMS, 30 tetor 2019, <https://www.mediasupport.org/new-global-study-documents-best-practices-on-the-safety-of-journalists/>.

²² Chocarro, Silvia, *Siguria e gazetarëve: Thyerja e ciklit të heshtjes dhe dhuna. Seria e librave të IMS Mbrojtja e Gazetarisë*, Danimarkë, publikuar nga Mbështetja Ndërkombëtare e Medias (IMS) (2019), <https://www.mediasupport.org/publication/the-safety-of-women-journalists/>.

²³ Reagimi i Shpejtë i Lirisë së Medias, "Mbrojtja e Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias: Praktikë e Mirë", MFRR, 2020, <https://www.mfrr.eu/wp-content/uploads/2020/06/MFRR-UK-Recommendations-Good-Practice.pdf>.

²⁴ Natalia Torres dhe Eduardo Bertoni, *Struktura Institucionale dhe Efektiviteti i Agjencive të Ngarkuara me Mbrojtjen e Gazetarëve dhe Hetimi e Krimeve ndaj Shtypit: Meksikë, Kolumbi dhe Guatemalë*, (Buenos Aires, Universiteti i Palermo, 2012) <https://www.palermo.edu/cele/cele/pdf/english/Internet-Free-of-Censorship/Institutional-Design.pdf>.

²⁵ Te ai dokument, fundshënimi 2.

²⁶ Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias, "Rekomandime pas Takimit të Ekspertëve - Sfidat e Reja ndaj Lirisë së Shprehjes: Kundërvënja ndaj Abuzimit Online të Gazetarëve", 17 shtator 2015, <https://www.osce.org/fom/193556?download=true>.

²⁷ "Objekti i Zhvillimit të Qëndrueshëm 16: Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, sigurimi i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet".

Platforma e Diëve për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së, Platforma e Diëve të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, <https://sustainabledevelopment.un.org/sdg16>.

²⁸ OSBE, *Sfidat e Reja ndaj Lirisë së Shprehjes: Kundërvënja ndaj Abuzimit Online të Gazetareve*, (Vjenë, Zyra e Përfaqësuesit për Lirinë e Medias, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 2016), <https://www.osce.org/fom/220411?download=true>.

²⁹ "Sekretariati IBAHRI i Panelit të Nivelit të Lartë të Ekspertëve Ligjorë për Lirinë e Medias", Shoqata Ndërkombëtare e Avokatisë, <https://www.ibanet.org/IBAHRI/Sekretariat.aspx>.

³⁰ Chapman, Martina, Hartëzimi i praktikave dhe masave të edukimit për median në BE-28, (Ed. nga Maj Capello), Strasburg, Observatori Audioviziv Evropian, 2016, fq. 28, 39. <https://rm.coe.int/1680783500>.

³¹ Robert Tomljenovic, *Autoritetet Rregullatore për Median Elektronike dhe Edukimin për Median – Analiza krahasuese të praktikave më të mira evropiane*, (Strasburg: Publikuar nga Këshilli i Evropës, 2018), <https://rm.coe.int/regulatory-authorities-for-electronic-media/1680903a2a>.

³² Kombet e Bashkuara, "Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim", miratuar më 15 shtator 1995, Konferenca e Katërt Botërore për Gratë, 4-15 shtator, Pekin, https://www.un.org/en/events/pastevents/pdfs/Beijing_Declaration_and_Platform_for_Action.pdf.

³³ "Rishikimi Periodik Universal", Këshilli i Të Drejtave të Njeriut i OKB-së, <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/upr/pages/uprmain.aspx>.

³⁴ "Rezolutat për Sigurinë e Gazetarëve: Si OKB-ja monitoron Zbatimin e tyre?", lajm nga IFEX, 22 dhjetor 2017, <https://ifex.org/resolutions-on-journalists-safety-how-does-the-un-monitor-their-implementation/>.

³⁵ "Procedurat e Posaçme të Këshillit të Të Drejtave të Njeriut", <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/sp/pages/welcomepage.aspx>.

³⁶ "Databaza e Rishikimeve Kombëtare Vullnetare", Platforma e Diëve e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së, <https://sustainabledevelopment.un.org/vnrs/>.

³⁷ "Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të UNESCO-s për Sigurinë e Gazetarëve dhe Rrezikun e Pandëshkueshmërisë", UNESCO, <https://en.unesco.org/themes/safety-journalists/dgreport>.

³⁸ "Tendencat Botërore në Lirinë e Shprehjes dhe Zhvillimin e Medias", UNESCO, <https://en.unesco.org/world-media-trends>.

³⁹ "Platforma për të promovuar mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve", Këshilli i Evropës, <https://www.coe.int/en/web/media-freedom>.

⁴⁰ UNESCO, *Sulme tëintensifikuara, mbrojtje të reja: zhvillimet në luftën për mbrojtje e gazetarëve dhe për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë*, botim nga InFocus për Tendencat Botërore në Lirinë e Shprehjes dhe Zhvillimin e Medias (Paris: UNESCO, 2019), <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000371487>.

⁴¹ "Delegacionet e OSBE-së krijojnë Grupin e Miqve për Sigurinë e Gazetarëve", Misioni i SHBA-së në OSBE, lajm, 23 prill 2018, <https://osce.usmission.gov/osce-delegations-establish-a-group-of-friends-on-safety-of-journalists/>.

⁴² "Konferenca e UNESCO-s trajton ngacmimin online të gazetarëve", lajm i UNESCO-s, 12 qershor 2019, <https://en.unesco.org/news/unesco-conference-tackles-online-harassment-female-journalists>.

⁴³ Austria, Kanadaja, Danimarka, Estonia, Franca, Gjermania, Greqia, Letonia, Lituania, Mali i Zi, Holanda, Norvegjia, Suedia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

⁴⁴ Indeksi Universal i Të Drejtave të Njeriut, <https://uhri.ohchr.org/>.

⁴⁵ ARTICLE 19, *Dhënia Fund Pandëshkueshmërisë: Veprimi për Standardet e OKB-së dhe Sigurinë e Gazetarëve* (Londër, Article 19, 2019), <https://www.article19.org/wp-content/uploads/2019/11/SOJ-Web.pdf>.

⁴⁶ "Mbrojtja e Gazetarëve dhe Aktivistëve", Partneriteti i Qeverisë së Hapur, <https://www.opengovpartnership.org/policy-area/defending-journalists-and-activists-expression/>.

⁴⁷ Media4Democracy, <https://media4democracy.eu/>.

⁴⁸ Komuniteti i Demokracive, *Udhëzues: Për Sigurinë e Gazetarëve për Personelin e Misioneve Diplomatieke, mars 2017*, <https://community-democracies.org/app/uploads/2018/06/Toolkit-Safety-of-Journalists-1-1.pdf>.

⁴⁹ Tarlach McGonagle, *Siguria e Gazetarëve dhe Lufta ndaj Korrupsionit në BE*, (Bruksel: Parlamenti Evropian, 2020), [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/655187/IPOL_STU\(2020\)655187_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/655187/IPOL_STU(2020)655187_EN.pdf)

B. Gjyqësori:

Garantimi i aksesit në drejtësi dhe dhënia fund pandëshkueshmërisë

Ky kapitull fokusohet te puna e gjykatave dhe gjyqtarëve që interpretojnë dhe zbatojnë ligjin, te funksionet që janë thelbësore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sigurinë e gazetarëve. Gjithashtu, ky kapitull përmban një seksion për institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut që kanë tagrin të mbrojnë dhe të promovojnë të drejtat e njeriut.

Një prej sfidave në adresimin e abuzimit dhe ngacmimit *online* ndaj gazetarëve është se shpesh kalon pa u denoncuar, prandaj garantimi i aksesit në drejtësi për to është thelbësor. Veçanërisht shqetësues është niveli i lartë i pandëshkueshmërisë për krimet ndaj gazetarëve – për rreth 90% të vrasjeve të raportuara të gazetarëve në mbarë botën.¹ Lufta ndaj pandëshkueshmërisë është nevojë absolute, sepse dëshmon dështimin sistematik të funksioneve të qeverisë dhe të shtetit të së drejtës, nga të cilat varen siguria dhe të drejtat e çdo individi.

Vendimi nr. 3/18 i Këshillit Ministror të OSBE-sëu bën thirrje Shteteve që “të marrin masa efektive për t’i dhënë fund pandëshkueshmërisë për krimet ndaj gazetarëve, duke garantuar llogaridhënien si një element kyç në parandalimin e sulmeve në të ardhmen, si edhe hetime të shpejta, efektive dhe të paanshme nga ana e agjencive ligjzbatuese për aktet e dhunës dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, me qëllim që përgjegjësit të sillen para drejtësisë dhe viktimat të kenë akses në mjete juridike të përshtatshme.”

Masat e propozuara

1. Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet gjinore në të gjithë sistemin gjyqësor, si çështje thelbësore për mbrojtjen e gazetarëve;
2. Rritja e ekspertizës mes personelit gjyqësor për çështjet e lirisë së shprehjes, sigurisë së gazetarëve, ngacmimit dhe abuzimit *offline* dhe *online*;
3. Vënia në zbatim dhe promovimi i praktikave më të mira për aksesin në drejtësi, dënimet dhe mjetet juridike;
4. Institucionet kombëtare përgjegjëse për të drejtat e njeriut duhet të angazhohen me çështjen e sigurisë së gazetarëve.

1. Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet gjinore në të gjithë sistemin gjyqësor, si çështje thelbësore për mbrojtjen e gazetarëve

Siguria *online* e gazetarëve ka nevojë për një sistem gjyqësor që mbron të drejtat e të gjithëve dhe është i vëmendshëm se si përjetohen përvojat e ndryshme nga burrat, gratë dhe personat me orientime seksuale të ndryshme, identitetet gjinore dhe shprehjet e tyre, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Për të realizuar këtë ideal, Shtetet duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet që të vlerësojnë dhe të reformojnë sistemin e drejtësisë, që të çojnë përpara barazinë gjinore. Ndër hapat e mundshëm drejt këtij synimi mund të jetë balancimi i përfaqësimit gjinor në personel dhe forcimi i kapaciteteve për të garantuar akses të barabartë në drejtësi.

Një prej sfidave në adresimin e abuzimit dhe ngacmimit *online* të gazetarëve është se shpesh rastet nuk denoncohen. Shumë faktorë kontribuojnë në këtë situatë, si frika e hakmarrjes, pasojat profesionale dhe stigmatizimi nga kolegët apo bashkëmoshatarët. Gjithashtu, masat mbrojtëse aktuale mund të jenë të pamjaftueshme për të mbrojtur dinjitetin e denoncuesve, mund të mbartin kosto ekonomike dhe të nxisin perceptimin se asgjë nuk do të ndryshojë; këta faktorë dekurajojnë gazetarët që t’i shkojnë deri në fund denoncimit. Hapat proaktivë për të lehtësuar aksesin në drejtësi, përfshirë shërbimet e ndihmës juridike dhe fushatat informuese, mund të ndihmojnë gazetarët të kapërcejnë disa prej këtyre pengesave. Promovimi i shtetit të së drejtës dhe garantimi i aksesit të barabartë në drejtësi për të gjithë, është një zotim i marrë përsipër në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Hapat për të përmirësuar numrin e rasteve të sigurisë së gazetarëve që trajtohen nga sistemi i drejtësisë mund të përfshijnë organizimin e dialogut ndërmjet gjyqësorit dhe gazetarëve, që të shkëmbejnë përvojat dhe të kuptohet më mirë se si abuzimi dhe ngacmimi *online* cenon jetën personale dhe profesionale të gazetarëve.

Shembuj

Trajnimi i profesionistëve gjyqësorë: Duke filluar nga vitit 2013, autoritetet e Bosnjë-Hercegovinës në bashkëpunim me Shoqatën e Gjyqtareve kanë trajnuar profesionistët gjyqësorë për aspektet gjinore në procedurat dhe praktikatat gjyqësore.

Mbështetja e rasteve që paraqiten në gjykatë: Në vitin 2018, autoriteti rregullator i medias për rajonin e Renit Verior-Vestfalisë në Gjermani, shpalli një projekt që ofron mbështetje juridike për agjencitë e lajmeve dhe gazetarët që të paraqesin në gjykatë padi për abuzim dhe ngacmim *online*.

Burimet

- OSBE-ja ka hartuar rekomandime të hollësishme se si të garantohet qasja gjinore në sistemin e drejtësisë, që gjenden në udhëzuesin [Drejtësia dhe Gjinia](#).
- Programi i Këshillit të Evropës për Edukimin mbi Të Drejtat e Njeriut për Profesionistët Ligjorë (HELP) ofron një kurs *online*, [Aksesi në Drejtësi për Gratë](#), që përmban module se si të përmirësohet aksesin në drejtësi për gratë dhe qasje me ndjeshmëri gjinore në ushtrimin e ligjit.
- Raporti i UNESCO-s [Parandalo dhe Ndëshko: në Kërkim të Zgjidhje për të Luftuar Dhunën ndaj Gazetarëve](#) përmban rekomandime se si të adresohet pandëshkueshmëria për krimet ndaj gazetarëve, edhe pse çështjet gjinore nuk trajtohen posaçërisht.

2. Rritja e ekspertizës mes personelit gjyqësor për çështjet e lirisë së shprehjes, sigurisë së gazetarëve, ngacmimit dhe abuzimit *offline* dhe *online*

Për të qenë në gjendje të përshtaten, personeli gjyqësor duhet të jetë i vetëdijshëm për përfitimet dhe sfidat e ndryshme që paraqet peizazhi mediatik dinamik për gazetarët dhe gazetaret. Temat si përmbushja dhe mbrojtja e të drejtës për lirinë e shprehjes në internet; rëndësia themelore e qasjeve me ndjeshmëri gjinore për të mbështetur këtë të drejtë; si dhe reagimi i duhur ndaj ngacmimeve dhe abuzimeve *online* duke ruajtur respektimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duhet të përfshihen në programet mësimore për edukimin ligjor dhe në programet e formimit profesional.

Këto kurse duhet të trajtojnë së paku pesë tema/çështje që prekin sigurinë e gazetarëve *online*:

- (1) një përmbledhje të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut mbi parandalimin, mbrojtjen dhe ndjekjen penale të krimeve kundër të drejtës së lirisë së shprehjes;
- (2) një tablo të qartë të kufizimeve të ligjshme ndaj të drejtës së lirisë së shprehjes dhe të ashtuquajturit test trepalësh (ligjshmëria, legjitimiteti dhe domosdoshmëria e proporcionaliteti), paraqiturnë kapitullin: Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që inkuadrojnë punën për sigurinë e gazetarëve *online*;
- (3) përfitimet dhe sfidat e së drejtës për lirinë e shprehjes *online* dhe panoramën se si funksionon interneti dhe media sociale;
- (4) një qasje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese për gëzimin e të drejtës për lirinë e shprehjes; dhe
- (5) rolin e gazetarisë dhe gazetarëve në shoqëritë demokratike.

Organizimi i trajnimeve në bashkëpunim me kolegët esistemeve gjyqësore përtej kufijve mund të jetë i paçmuar për të gjithë personat e përfshirë. Një seminar me gjyqtarët apo individëve të tjerë që punojnë në sektorin e drejtësisë, nga Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së për shembull, mundëson shkëmbim produktiv të përvojave dhe mësimave të nxjerra.

Shembuj

Organizimi i Kurseve të Hapura Masive Online: Që nga viti 2014, mbi 12 000 gjyqtarë kanë marrë pjesë në Kurset e Hapura Masive *Online* të organizuara nga UNESCO për të rritur njohuritë e tyre mbi çështjet e lirisë së shprehjes. Kurset janë pritur shumë mirë nga pjesëmarrësit, përshtypjet e të cilëve tregojnë se trajnimet i kanë ndihmuar të kuptojnë më mirë problematikat lidhur me sigurinë e gazetarëve.

Pjesëmarrja në trajnime individuale: Që nga viti 2016, mbi 4 000 gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe profesionistë të medias kanë marrë pjesë në projektin [JUFREX](#) të Këshillit të Evropës për të zgjeruar njohuritë mbi lirinë e shprehjes dhe sigurinë e gazetarëve në Evropën juglindore.

Ngritja e gjykatave të posaçme: Estonia ngriti një gjykatë të posaçme për ngacmimet *online*; gjyqtarët dhe punonjësit e agjencive ligjzbatuese kanë marrë trajnim të specializuar për këtë çështje.

Burimet

- UNESCO publikoi një udhëzues për [Standardet Ligjore për Lirinë e Shprehjes në Afrikë](#) që përmban një seksion për perspektivat gjinore në lirinë e shprehjes. UNESCO në bashkëpunim me Qendrën për Asistencë

Ndërkombëtare të Medias publikoi edhe udhëzuesin për [Standardet Ndërkombëtare për Lirinë e Shprehjes: Udhëzues Bazë për Juristët në Amerikën Latine dhe Karaibe](#)-si edhe një modul mësimor për gjyqtarët mbi lirinë e shprehjes, aksesin në informacion dhe sigurinë e gazetarëve.

- [Mbrojtja e Të Drejtës për Lirinë e Shprehjes në kuadrin e Konventës Evropiane të Të Drejtave të Njeriut](#), është udhëzues i Këshillit të Evropës që ofron rekomandime mbi sigurinë e gazetarëve.
- Trajnim *online* mbi sigurinë e gazetarëve për gjyqtarët dhe juristët që përcakton bazat për mbrojtjen dhe ndjekjen penale për dhunën ndaj gazetarëve. Gjendet në [Platformën online HELP të Këshillit të Evropës](#) në disa gjuhë.

3. Vënia në zbatim dhe promovimi i praktikave më të mira për aksesin në drejtësi, dënimet dhe mjetet juridike

Ndjekja e rastit në rrugë gjyqësore në mënyrë të pavarur mund të jetë traumatike dhe kohëshpenzuese për personin objekt i dhunës, prandaj duhet të ekzistojë një sistem që siguron shqyrtim gjyqësor të shpejtë dhe ofron ndihmë juridike dhe mjete juridike. Mjetet juridike duhet të jenë proporcionale me peshën e shkeljeve dhe mund të përfshijnë kompensim financiar dhe një sërë masash për rehabilitimin e viktimave dhe lehtësimin e kthimit të tyre në punë, nëse dëshirojnë.

Kur gjykatat shqyrtojnë rastet e ngacmimit dhe abuzimit *online* ndaj gazetarëve, gjatë vendimmarrjes për masën e dënimit dhe mjetet juridike, duhet të peshojnë ndikimin që shkelja ka pasur te e drejta për lirinë e shprehjes dhe te liria e shtypit. Gjatë përcaktimit të masës së dënimit, gjyqtarët duhet të mbajnë parasysh praktikën më të mira në rastet e sulmeve kundër gazetarëve të trajtuara nga gjykata të tjera, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Gjyqësori mund të referohet te jurisprudenca gjithnjë e më e pasur. Kjo mund t'u shërbejë shkelësve shtetërorë apo joshetërorë që të jenë plotësisht të vetëdijshëm se do të ndëshkohen për veprimet e tyre dhe se gjykatat do të ndërmarrin masa korrigjuese ndaj palës së dëmtuar. Një masë e tillë mund të jetë dhënia e dëmshpërblimit për gazetarin që ka pësuar shkeljen.

Organet gjyqësore duhet të promovojnë përfundimin e luftës ndaj pandëshkueshmërisë, në bashkëpunim me prokurorë të posaçëm dhe komisione të pavarura të ngritura nga palë të ndryshme të interesit. Kjo mund të përfshijë bashkëpunimin me komisione të posaçme që monitorojnë efektivitetin e hetimeve, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse, organizatat e medias dhe organizatat e shoqërisë civile.

Shembuj

Masa e dënimit: Në Francë, dy individë u dënuan me 6 muaj burg me kusht dhe 2,000 Euro gjobësepe bënë në internet kërcënime për vrasje dhe përdhunim. Objektivi i tyre ishte një gazetar francez që u shënjestrua për 8 muaj me ngacmime *online*. Në Irlandë, një individ u dënuua me 4.5 vjet burg (18 muajt e fundit ishin me kusht) për ngacmimin e një gazetareje, bazuar në Ligjin për Veprat Penale Jovdekjeprurëse ndaj Personit.

Hetimeve publike: Në nëntor 2019, u ngrit një hetim publik për vrasjen e Daphne Caruana Galizia në Maltë, pas avokimit të fuqishëm nga familja e viktimës, një rezolute të Komitetit të Çështjeve Ligjore të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, si edhe presionit nga organizatat e tjera ndërkombëtare.

Dhënia e dëmshpërblimit financiar: Në Finlandë, një gjykatë i dha dëmshpërblim një gazetareje në masën 94 000 Euro, bashkë me kompensimin e shpenzimeve mjekësore, fitimit të munguar dhe sigurisë, pasi ishte objekt i ngacmimit *online*, përndjekjes dhe shpifjeve nga tre individë.

Garantimi i mjeteve juridike civile: Në shumë vende, viktimat mund të paraqesë padi civile për dëmshpërblim, nëse abuzimi apo ngacmimi *online* shkel të drejtën kushtetuese të jetës private, për shembull sipas legjislacionit irlandez.

Burimet

- Jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) mund ta gjeni në raportin e Këshillit të Evropës [Liria e shprehjes, media dhe gazetarët: Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Të Drejtave të Njeriut](#). Është edhe trajnimi *online* HELP i Këshillit të Evropës për [Arsyetime të Vendimeve dhe Prezantimi me GjEDNj-në](#).
- Observatori Audioviziv Evropian [databaza IRIS Merlin](#) përmban informacion të dobishëm për çështjet ligjore të medias, si edhe për mbrojtjen e gazetarëve.
- Universiteti i Kolumbias ka databazën [Jurisprudenca për Lirinë Globale të Shprehjes](#) ofron akses në qindra vendime për lirinë e shprehjes në mbarë botën, si edhe për sigurinë e gazetarëve.

- Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Oksfordit publikoi [Raportin për Dëshmipërblimet dhe Masat Juridike për Viktimat e Dhunës Seksuale dhe Dhunës me Bazë Gjinore](#) që i referohet jurisprudencës ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare.

4. Institucionet kombëtare përgjegjëse për të drejtat e njeriut duhet të angazhohen me çështjen e sigurisë së gazetarëve

Pavarësisht nëse konstituohen si komision, avokat populli apo formë tjetër, institucionet e pavarura publike kombëtare përgjegjëse për të drejtat e njeriut (IKDNj) janë të përshtatshme për të adresuar çështjen e sigurisë së gazetarëve, përfshirë çështjen e abuzimit dhe ngacmimit *online* të gazetarëve. IKDNj-të mund t'i kushtojnë vëmendje sigurisë së gazetarëve përmes monitorimit, edukimit dhe komunikimit strategjik, si dhe përmes shqyrtimit të ankesave dhe parandalimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe abuzimeve ndaj gazetarëve. Për shembull, IKDNj-të kanë tagrin të merren me ankesa individuale dhe të veprojnë si ndërmjetës me ankuesit dhe organeve të administratës publike që nuk kanë përmbushur detyrimin për të mbrojtur të drejtat e njeriut. Përveç kësaj, IKDNj-të mund të bëjnë deklaratë publike, të ndërmarrin fushata ndërgjegjësimi dhe të publikojnë kërkime tematike.

IKDNj-të janë në pozitën e duhur për të monitoruar sulmet ndaj gazetarëve, përfshirë ngacmimet dhe abuzimet *online*. Si institucione të pavarura publike, IKDNj-të janë në pozitën e duhur edhe për të krijuar sistemi për mbledhjen e statistikave lidhur me shtrirjen dhe ndikimin të sigurisë së gazetarëve, statistika këto që mund të shërbejnë si informacion i dobishëm për politikën publike dhe mekanizmat ndërkombëtarë si Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Në disa raste, IKDNj-të kanë kompetenca pothuaj juridiksionale, që i lejon të rekomandojnë apo të nxisin mjete juridike, ose të luajnë rol në zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve. Zgjidhje të tilla alternative mund të mirëprehen në rastet e ngacmimit gjinor *online* dhe *offline* ndaj grave që nuk duan të përfshihen në procedura të hapura gjyqësore.

Ashtu si institucionet e tjera, IKDNj-të duhet të garantojnë qasje me ndjeshmëri gjinore në punën e tyre dhe të alokojnë burimet e duhura njerëzore dhe financiare për zbatimin efektiv të një qasjeje të tillë.

Shembuj

Hartimi i raporteve nga Avokati i Popullit për të Drejtat e Njeriut: Avokati i Popullit për Të Drejtat e Njeriut në Bosnjë/Hercegovinë hartoi një [Raport të Posaçëm për Ecurinë e Çështjeve për Kërcënimet ndaj Gazetarëve](#). Raporti evidenton sfidat kryesore të sigurisë së gazetarëve, përfshirë abuzimin dhe ngacmimin *online*, si edhe në çfarë mase këto sfida janë trajtuar siç duhet nga ana e Shtetit.⁶

Publikimi i raporteve në bashkëpunim me median: Avokati i Popullit (Seimas) në Lituani bashkëpunon me median, sidomos me Shoqatën e Radiostacioneve Rajonale, për të zhvilluar programe të përbashkëta mbi çështjet e të drejtave të njeriut. Në këtë nismë të përbashkët, gazetarët radiofonikë përgatisin programacionin duke përfshirë kontribute nga Avokati i Popullit. Kjo mënyrë ofron një forum për të transmetuar problematikat e lirisë së shprehjes dhe dhunës ndaj gazetarëve, përfshirë abuzimin dhe ngacmimin *online*.⁶

Burimet

- [Manuali për Institucionet Kombëtare të Të Drejtave të Njeriut mbi Të Drejtat e Grave dhe Barazia Gjinore](#) hartuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) ofron këshilla të dobishme për integrimin e aspekteve gjinore në punën e IKDNj-ve.⁶

¹ UNESCO, 2019, Sulme të intensifikuara, mbrojtje të reja: zhvillimet në luftën për të mbrojtur gazetarët dhe për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000371487>.

²William Horsley, *Manuali i OSBE-së për Sigurinë e Gazetarëve*, Botimi i dytë, faqja 23, (Vjenë: Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias, 2014), <https://www.osce.org/fom/118052?download=true>.

³Eleanor Gordon, *Drejtësia dhe Gjinia, në një Udhëzues për Gjininë dhe Sigurinë*, (Vjenë: DCAF, OSBE/Zyra për Institucione Demokratike dhe Të Drejtat e Njeriut, (ODIHR), *UN Women*, 2019), https://www.dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/GSToolkit_Tool-4%20EN%20FINAL_1.pdf.

⁴Edison Lanza, IACHR, PLeM, "Gazetarët dhe Liria e Shprehjes: Diskriminimi dhe dhuna me bazë gjinore me të cilën përballen gazetarët gjatë ushtrimit të profesionit", (OEA/SER.LV/II CIDH/RELE/INF.17/17), 31 tetor 2018, <http://www.oas.org/en/iachr/expression/docs/reports/WomenJournalists.pdf>.

⁵"Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 16: Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, siguri i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet".

Platforma e Dijeve për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së, <https://sustainabledevelopment.un.org/sdg16>.

⁶ Te dokumenti i cituar, fundshënimi 3.

- ⁷ Barbara Trionfi dhe Javier Luque Martinez, "Praktikat më Të Mira të Redaksive të Lajmeve për Adresimin e Dhunës Online ndaj Gazetarëve: Perspektiva nga Finlanda, Gjermania, Polonia, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar", (Vjenë: IPI, 2018), <https://newsrooms-ontheline.ipi.media/ép-content/uploads/2019/06/IPI-report-online-harassment-06032019.pdf>.
- ⁸ Lorraine Andaya Serrano, *Integrimi i Gjinisë në Hartimin dhe Monitorimin e Projekteve për Sigurinë dhe Sektorin e Drejtësisë, në Udhëzuesin për Gjirinë dhe Sigurinë*, (Vjenë: DCAF, OSBE/ODIHR, UN Women, 2019). https://dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/GSToolkit_Tool-15%20EN%20FINAL_0.pdf
- ⁹ Kurset Online HELP të Këshillit të Evropës, <http://help.elearning.ext.coe.int/>.
- ¹⁰ Eduardo Bertoni, *Parandalo dhe Ndëshko: Në kërkim të zgjidhjeve për të luftuar dhunën ndaj gazetarëve*, (Paris: UNESCO, 2015), https://en.unesco.org/sites/default/files/prevent-and-punish_bertoni.pdf.
- ¹¹ Catalina Botero, *Guía político-pedagógica sobre la incorporación de la temática de libertad de expresión y de acceso a la información pública en la formación de operadores judiciales en América Latina*, (Paris: UNESCO, 2016), <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000243750>.
- ¹² Rosental Calmon Alves, "Trajnimi i Gjyqtarëve Online për të Mbrojtur Gazetarët", në UNESCO Courier, prill – qershor 2017, <https://en.unesco.org/courier/2017-april-june/training-judges-online-safeguard-journalists>.
- ¹³ "Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore për Lirinë e Shprehjes dhe Median në Evropën Juglindore (JUFREX)", Këshilli i Evropës, Liria e Shprehjes në Evropën Juglindore (JUFREX), <https://www.coe.int/en/ëeb/freedom-expression/promoting-freedom-of-expression-in-south-east-europe>.
- ¹⁴ Peter Noolander, "Për sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias, për Konferencën e Ministrave përgjegjës për Median dhe Shoqërinë e Informacionit", Punim i Përgjithshëm për zbatimin i KMrek(2016)4, Qipro, maj 2020, <https://rm.coe.int/background-paper-safety-of-journalists-and-other-media-actorsfinal/168094b396>.
- ¹⁵ UNESCO, *Standardet Ligjore për Lirinë e Shprehjes: Udhëzues për Gjyqësorin në Afrikë*, (Paris: UNESCO, 2018), <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000366340>.
- ¹⁶ Silvia Chocarro, *Standardet ndërkombëtare për lirinë e shprehjes: Udhëzues bazë për juristët*, (Uashington: Qendra për Asistencën Ndërkombëtare të Medias, 2018), <https://www.cima.ned.org/resource/international-standards-on-freedom-of-expression-a-basic-guide-for-legal-practitioners-in-latin-america-and-the-caribbean/>.
- ¹⁷ UNESCO, *Caja de herramientas para escuelas judiciales iberoamericanas*, (Paris: Unesco, 2017), <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000251593>.
- ¹⁸ Dominika Bychawska-Siniarska, *Mbrojtja e Të Drejtës për Lirinë e Shprehjes në kuarin e Konventës Ndërkombëtare për Të Drejtat e Njeriut*, (Këshilli i Evropës, 2017), <https://rm.coe.int/handbook-freedom-of-expression-eng/1680732814>.
- ¹⁹ <http://help.elearning.ext.coe.int/>.
- ²⁰ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, "Deklaratë e përbashkët për krimet ndaj lirisë së shprehjes", 25 qershor 2012 <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/91595>.
- ²¹ Te dokumenti i cituar, fundshënimi 26.
- ²² Scott Griffen, "Përgjigjet Ligjore ndaj Abuzimit dhe Ngacimit Online të Gazetarëve: Perspektiva nga Finlanda, Franca dhe Irlanda", OSBE, Përfaqësuesi për Lirinë e Medias, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/413552?download=true>.
- ²³ Te dokumenti i cituar, fundshënimi 5.
- ²⁴ "RSF publikoi raportin për ngacimin online të gazetarëve", Artikull nga Reporterët Pa Kufi, 1 gusht 2018, <https://rsf.org/en/news/rsf-publishes-report-online-harassment-journalists>.
- ²⁵ Te dokumenti i cituar, fundshënimi 22.
- ²⁶ Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Rezoluta nr. 2293, "Vrasja e Daphne Caruana Galizia-s dhe shteti i së drejtës në Maltë dhe përtej: të sigurohemi të dalë e gjithë e vërteta", 26 qershor 2019, <http://assembly.coe.int/nè/xml/XRef/Xref-DocDetails-EN.asp?fileid=28053>.
- ²⁷ Te dokumenti i cituar, fundshënimi 27.
- ²⁸ Te dokumenti i cituar, fundshënimi 26.
- ²⁹ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Rezoluta 74/157 për Sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e pandëshkueshmërisë, 18 dhjetor 2019, <https://undocs.org/A/RES/74/157>
- ³⁰ Avokati i Popullit për Të Drejtat e Njeriut në Bosnjë-Hercegovinë, "Raport i Posaçëm për Ecurinë e Çështjeve për Kërcënimet ndaj Gazetarëve në Bosnjë-Hercegovinë", qershor 2017, https://www.ombudsmen.gov.ba/documents/obmudsmen_doc2017082415202346eng.pdf.
- ³¹ OECD, "Roli i institucioneve të Avokatit të Popullit në Qeveritë e Hapura, Dokument Pune i OECD-së për Qeverisjen Publike nr. 29", <https://www.oecd.org/gov/the-role-of-ombudsman-institutions-in-open-government.pdf>.
- ³² OSCE, "Manual për Institucionet Kombëtare për Të Drejtat e Njeriut mbi Të Drejtat e Grave dhe Barazinë Gjimore", (Varshavë: OSBE/ODIHR, 2012) <https://www.osce.org/odihr/97756?download=true>.

C. Agjencitë ligjzbatuese:

Forcimi i metodave për mbrojtjen dhe për hetime efikase

Kjo pjesë merret me organet shtetërore që duhet të përmbushin detyrimin për të mbrojtur gazetarët dhe për të hetuar në mënyrë efektive krimet ndaj tyre: agjencitë ligjzbatuese. Gazetarët përballen me rreziqe të veçanta që lidhen me punën e tyre, gjë që kërkon qasje me ndjeshmëri gjinore për sigurinë e tyre. Hetimi i krimeve ndaj gazetarëve të kryera në mjedisin dixhital janë ende një fushë në zhvillim. Çdo propozim i ri për t'iu kundërvënë praktikave të dëmshme *online* duhet të vlerësohet me kujdes, për të garantuar që të mos cenohet mbrojtja dhe ushtrimi i të drejtave të njeriut *online*, përfshirë të drejtën për lirinë e shprehjes dhe jetën private.

Kjo pjesë ofron një përmbledhje të rekomandimeve dhe standardeve ekzistuese për hetimin efektiv të krimeve ndaj gazetarëve (përfshirë ato në [Vendimin nr. 3/18 të Këshillit Ministror të OSBE-së](#)) për të adresuar gamën e abuzimeve dhe ngacmimeve *online* ndaj gazetarëve. Gjithashtu, propozon hapat minimale që mund të ndërmarrin autoritetet ligjzbatuese për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

*Vendimi nr. 3/18 i Këshillit Ministror të OSBE-së*ubën thirrje Shteteve që “të nxisin organet shtetërore dhe agjencitë ligjzbatuese që të angazhohen në aktivitete ndërgjegjësimi dhe trajnimi lidhur me nevojën për të garantuar sigurinë e gazetarëve, si edhe të promovojnë përfshirjen e shoqërisë civile në aktivitete të tilla, sipas rastit.”

Masat e propozuara

1. Organizimi i më shumë trajnimeve për autoritetet ligjzbatuese mbi çështjen e sigurisë *online* të gazetarëve, me qasje me ndjeshmëri gjinore;
2. Shqyrtimi dhe përmirësimi i aspekteve gjinore në vlerësimet e riskut të kërcënimeve dhe ngacmimeve;
3. Forcimi i protokolleve, metodave dhe procedurave për hetimin e krimeve ndaj gazetarëve dhe për lirinë e shprehjes;
4. Rritja e dialogut dhe bashkërendimit për sigurinë e gazetarëve mes autoriteteve ligjzbatuese, operatorëve mediatikë dhe shoqërisë civile.

1. Organizimi i më shumë trajnimeve për autoritetet ligjzbatuese mbi çështjen e sigurisë *online* të gazetarëve, me qasje me ndjeshmëri gjinore

Meqenëse oficerët ligjzbatues nuk mund të jenë gjithmonë të vëmendshëm ndaj standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe sigurisë së gazetarëve në punën e tyre të përditshme, programet e trajnimit mund të luajnë rol konstruktiv për t'i ndihmuar të kuptojnë më mirë të drejtat e gazetarëve, gamën e kërcënimeve me të cilat përballen dhe mjetet për t'u përgjigjur. Programe të tilla trajnimi duhet të përfshijnë disa komponentë dhe rekomandime se si të krijojnë procedura që inkurajojnë gazetarët të denoncojnë sulmet *online* dhe *offline* pranë autoriteteve përgjegjëse, së bashku me praktika që parandalojnë ri-traumatizimin. Një perspektivë e përgjithshme mbi përdorimin, keqpërdorimin dhe përfitimet e teknologjisë, si dhe module praktike që ofrojnë mjete dhe njohuri mbi aspektet ligjore dhe teknike, duhet të përcjellin format e ndryshme në të cilat shfaqet abuzimi dhe ngacmimi me bazë gjinore *online*, si dhe rrethanat specifike në të cilat kërcënimet dhe ngacmimet *online* përbëjnë vepër penale që duhet të trajtohet njësoj si krimet *offline*.

Këto trajnime duhet të jenë të detyrueshme për të gjithë personelin ligjzbatues, sidomos për policinë që merr denoncimet dhe hetuesit, si dhe duhet të përfshijnë afate të caktuara për përfundimin. Modulet e barazisë dhe mosdiskriminimit duhet të përfshijnë masa për t'iu kundërvënë pengesave me të cilat përballen gratë në aksesin në drejtësi, siç janë diskriminimi strukturor dhe diskriminimi i shënjestruar në sistemin e drejtësisë penale.

Masat parandaluese janë thelbësore, ashtu si edhe procedurat për të identifikuar rreziqet dhe kërcënimet e veçanta me të cilat përballen gazetarët *online* krahasuar me ato me të cilat përballen kolegët e tyre meshkuj. Autoritetet ligjzbatuese duhet t'u japin përparësi kërcënimeve për jetën ose integritetin fizik, duke përfshirë kërcënimet e përdhunimit dhe akte të tjera penale *online* me potencialin që të manifestohen *offline*.

Personeli ligjzbatues duhet të përgatitet mirë në masat praktike në dispozicion për të parandaluar dhe zbutur ndikimet negative të ngacmimit dhe abuzimit me bazë gjinore. Për shembull, ata duhet të bëhen të vetëdijshëm për mundësitë që ofrojnë mjetet dixhitale të sigurisë për të parandaluar hyrjen e paautorizuar në llogaritë dixhitale të gazetarëve. Autoritetet duhet të jenë të vetëdijshëm për aspektet unike të punës së gazetarëve, si nevoja

thelbësore për të mbrojtur burimin e informacionit dhe ndikimin që lloje të ndryshme të ngacmimeve dhe abuzimeve kanë në jetën e tyre personale dhe profesionale.

Trajnimet duhet t'i bëjnë agjencitë ligjzbatuese të ndërgjegjshme dhe të vetëdijshme për tendencën tradicionale dhe ende mbizotëruese për të fajësuar gratë për abuzimin dhe ngacmimin me bazë gjinorë ndaj tyre. Trajnimet duhet edhe të nxjerrin në pah barrën dhe ndikimin psikologjik të denoncimit dhe ndjekjes së rasteve të tilla. Identifikimi i shkaqeve rrënjësore pse anashkalohe denoncimet e gazetareve për abuzimin dhe ngacmimin *online* duhet të ofrojnë informacion për të formuluar masa që parandalojnë dhe mbrojnë gazetaret nga sulmet ndaj tyre.

Gjithashtu, efektivët ligjzbatues duhet të trajnohen dhe të informohen mbi zbatimin e masave mbrojtëse për gazetaret në rastet kur akte të caktuara nuk përbëjnë vepër penale.

Shembuj

Ofrimi i trajnimit online për policinë: Autoriteti Policor Suedez në bashkëpunim me Universitetin Uppsala filluan një [trajnim online për efektivët e policisë](#) që merren me krimet e urrejtjes, lirinë e shprehjes, lirinë e shtypit dhe të drejtat dhe liritë themelore të gazetarëve, opinionbërësve dhe politikanëve.

Publikimi i manualeve për policinë: [Manuali i Departamentit Kanadez të Drejtësisë për Policinë dhe Prokurorët e Kurorës për Ngacmimet Penale](#) tregon llojet e ndryshme të ngacmimeve *online* dhe ligjet e procedurat e ndryshme që mund të ndiqen për të hetuar vepra penale të tilla.

Burimet

- Manual trajnimi për [Lirinë e Shprehjes dhe Rendin Publik](#), publikuar nga UNESCO, synon të pajisë forcat e sigurisë me mjete për të ruajtur rendin publik duke respektuar të drejtat e njeriut dhe lirinë e shprehjes, duke garantuar njëkohësisht sigurinë e gazetarëve. Manuali është përdorur në seminare dhe trajnime si pjesë e zbatimit të Planit të Veprimit të OKB-së për Sigurinë e Gazetarëve në mjaft vende, si në Kirgistan, Taxhikistan dhe Uzbekistan.
- Për të ndihmuar agjencitë ligjzbatuese që të hetojnë më mirë abuzimin dhe ngacmimin *online* të gazetareve, ARTICLE 19 përgatiti një dokument informues: [Hetimi i Abuzimit dhe Ngacimit Online i Gazetareve](#).

2. Shqyrtimi dhe përmirësimi i aspekteve gjinore në vlerësimet e riskut të kërcënimeve dhe ngacmimeve

Diskriminimi dhe pabarazia me të cilën përballen gratë *offline* shpesh pasqyrohet edhe *online*. Autoritetet ligjzbatuese duhet të jenë të vetëdijshme për këto rrethana, sidomos në rastet kur gazetaret janë zëra të fortë që ekspozojnë sjellje që bien ndesh me normat shoqërore dhe stereotipe gjinore që mund t'i vënë edhe më shumë në rrezik.

Autoritetet ligjzbatuese duhet të bëjnë vlerësim tërësor të procedurave dhe masave që aplikojnë për të vlerësuar nivelin e riskut për kërcënimet *online* dhe *offline* ndaj gazetarëve. Ky vlerësim duhet të përfshijë nivelin e riskut që i atashohet secilit lloj kërcënimi që jo detyrimisht kategorizohen në vepër penale, qoftë *online* apo *offline*, përfshirë edhe lidhjen mes këtyre dydimensioneve. Ky vlerësim tërësor duhet të rezultojë në praktika që synojnë të zhvillojnë një protokoll, në kuptimin e një sërë metodash, procedurash dhe standardesh që drejtojnë punën e autoriteteve në hetimin dhe përgjigjet ndaj kërcënimeve dhe rreziqeve me të cilat përballen gazetaret.

Të gjithë raportet për kërcënimet përgatitur nga oficerët ligjzbatues duhet të përmbajnë një përshkrim të hollësishëm të vlerësimeve dhe masave të rekomanduara, si dhe konsiderata faktike, kontekstuale dhe gjinore që jepen nga gazetari dhe specialisti gjinor, nëse ka, që kryejnë bashkë vlerësimin ose hetimin.

Vlerësimet e rrezikut duhet të përmbajnë një seksion që përfshin dhe konsideron modelet e sjelljes dhe aspektet gjinore të incidentit të tilla si stereotipet, diskriminimi, intoleranca, kërcënimet e seksualizuara dhe frikësimi. Ky informacion duhet të përdoret për të përcaktuar veprimet në vijim dhe për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave në lidhje me manifestime të ndryshme të ngacmimit dhe abuzimit online ndaj gazetarëve.

Funksionet ligjzbatuese mund të kontribuojnë për t'i kuptuar më mirë dhe për të zhvilluar përgjigje rregullatore ndaj ngacmimit dhe abuzimit online ndaj gazetarëve. Autoritetet duhet të autorizojnë ose mbështesin mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e tyre në lidhje me këtë çështje. Kjo punë mund të udhëzojë dhe përforcojë përgjigjet parandaluese dhe hetimore, në përputhje të plotë me detyrimet për mbrojtjen e të dhënave dhe standardet për mbrojtjen e privatësisë. Gazetarët që raportojnë një incident duhet të jenë të mirinformuar për përdorimin dhe përpunimin e informacionit të tyre, si dhe të mjeteve juridike që mund të aksesojnë në rast shkeljesh apo abuzimesh.

Shembuj

- **Krijimi i protokolleve për vlerësimin e kërcënimeve dhe rreziqeve:**Me qëllim hartimin e një protokollit standard për të vlerësuar rreziqet,⁶ si dhe përmirësimin e përgjigjeve të përbashkëta që autoritetet ligjzbatuese u ofrojnë gazetarëve që përballen me rreziqe të caktuara në punën e tyre, Relatori i Posaçëm i OKB-së për ekzekutimet jashtëgjyqësore, direkte apo arbitrare u ka bërë thirrje Shteteve që të mbështetin mbledhjen e praktikave të mira në hetimin, vlerësimin dhe/ose përgjigjen ndaj kërcënimeve dhe rreziqeve të gazetarëve. Këto protokolle duhet të inkorporojnë nocionet dixhitale dhe teknologjike të kërcënimeve dhe rreziqeve me të cilat përballen gazetarët.

3. Forcimi i protokolleve, metodave dhe procedurave për hetimin e krimeve ndaj gazetarëve dhe për lirinë e shprehjes

Përforcimi i hetimeve për sulmet ndaj gazetarëve është parësor për trajtimin e pandëshkueshmërisë, por, duke ndjekur këtë logjikë, është e rëndësishme të inkorporohet një qasje gjinore që i përgjigjet manifestimeve, ndikimeve dhe rreziqeve të ndryshme me të cilat përballen gratë në krahasim nga burrat.⁷

Adresimi i pandëshkueshmërisë së krimeve ndaj gazetarëve kërkon hetime të kujdesshme, të paanshme, dhe efektive që synojnë të konstatojnë të vërtetën dhe të ndjekin, të arrestojnë, të procedojnë penalisht dhe, në fund, të ndëshkojnë të gjithë autorët e krimeve ndaj gazetarëve.⁸

Një nga masat që duhet të ndërmarrin autoritetet ligjzbatuese është krijimi i njësive të posaçme brenda policisë dhe prokurorisë për hetimin e krimeve ndaj gazetarëve, ose vendosja e planeve të veprimeve të ngjashme ose adekuate që mundësojnë trajtimin me përparësi dhe të specializuar të hetimit të krimeve ndaj gazetarëve. Këto njësi ose veprime të posaçme duhet ta mbështesin funksionimin e tyre në metodat, procedurat ose protokollin e zhvilluar përmes praktikave të mira të përbashkëta.

Pastaj, agjencitë ligjzbatuese duhet të përftojnë burime të mjaftueshme për të trajtuar me përparësi vlerësimet e rrezikut dhe hetimet e krimeve ndaj gazetarëve. Për më tepër, atyre duhet t'i jepet tagri për hartimin e një grupi të specializuar standardesh, procedurash dhe protokolleve për të siguruar se hetimi i krimeve ndaj gazetarëve përfshin, si rregull, shterimin e disa pyetjeve që lidhen me veprimtarinë gazetareske të viktimës. Kur agjencitë ligjzbatuese vendosin që të mos t'i ndjekin dhe shterojnë këto pyetje, ato duhet ta arsyetojnë me shkrim këtë vendim si dhe të marrin miratimin e një zyrtari të nivelit më të lartë. Për çështjet që kanë të bëjnë me gazetaret, raporti duhet të theksojë konsideratat gjinore.

Kur kërcënimet dhe ngacmimet *online* përbëjnë vepra penale që duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si krimet *offline*, autoritetet ligjzbatuese duhet të vlerësojnë protokollin e tyre ekzistues të hetimit dhe masat parandaluese në mënyrë që të identifikojnë praktikën më të mira dhe mësimet e nxjerra nga të gjitha procedurat e zbatueshme për parandalimin dhe hetimin e këtyre krimeve. Në dobi të këtij vlerësimi do të ishte pjesëmarrja e organizatave dhe ekspertëve që punojnë me individë të abuzuar, si dhe gazetarë që kanë hasur pengesa në aksesimin e sistemit të drejtësisë penale.

Shembuj

Dhënia e udhëzimeve gjyqësore në nivel të lartë: Prokuroria e Kurorës së Mbretërisë së Bashkuar ka dhënë udhëzime për vendimet në çështjet që kanë të bëjnë me komunikime të dërguara përmes medias sociale me anë të botimit të saj të vitit 2018 [Media Sociale – Udhëzime në ndjekjen penale të çështjeve që kanë të bëjnë me komunikime të dërguara përmes medias sociale](#) që përmban sqarime se cilat komunikime të medias sociale mund të konsiderohen si vepra penale.⁹

Caktimi i përgjegjësisë së posaçme: Policia e Kosovës ka caktuar Departamentin e saj të Krimeve të Rënda për të hetuar sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve. Në një masë të ngjashme, Gjykata Themelore e Kosovës ka emëruar një koordinator për çështjet e gazetarëve.¹⁰

Burimet

- Një numër organizatash të shoqërisë civile, së bashku me Prokurorinë Publike, kanë miratuar një protokoll të posaçëm për të hetuar krimet ndaj lirisë së shprehjes në Meksikë. Ai përmban standardet operacionale të hetimit dhe mbledhjes së provave, bashkëpunimin midis autoriteteve të ndryshme, masat për orientimin dhe lidhjen e individëve objekt të dhunës me shërbimet përkatëse si dhe për garantimin e sigurisë së tyre.¹¹

4. Rritja e dialogut dhe bashkërendimit për sigurinë e gazetarëve mes autoriteteve ligjzbatuese, operatorëve mediatikë dhe shoqërisë civile

Për të krijuar besimin e publikut në shtetin e së drejtës dhe për të trajtuar diskriminimin gjinor në mënyrë efektive, autoritetet ligjzbatuese duhet të promovojnë, lehtësojnë dhe nxisin koordinimin ndërmjet policisë, prokurorëve, organizatave mediatike dhe shoqërisë civile. Është e rëndësishme që gazetaret objekt të krimeve *online* dhe/ose *offline* t'i kallëzojnë krimet në polici.

Dialogët ndërmjet këtyre palëve duhet të përqendrohen në adresimin e shkaqeve zanafillë të pandëshkueshmërisë së krimeve ndaj gazetarëve dhe rolin e teknologjisë në ushtrimin e të drejtave të njeriut si dhe paraqitjen e rreziqeve në të drejtat e gazetarëve. Këta dialogë duhet të zhvillohen me mirëkuptimin e përbashkët nga të gjitha palët se është thelbësore dhënia e kontributit nga personat objekt të sulmeve dhe nga grupet që mbështesin personat të cilët kanë përjetuar ngacmim dhe abuzim online kur agjencitë ligjzbatuese të duan të hartojnë, zhvillojnë ose zbatojnë procedura për trajtimin e praktikave diskriminuese dhe pengesave strukturore. Koordinimi midis pjesëmarrësve duhet të hartojë metoda dhe procedura të reja, ose të forcojë ato ekzistuese për të siguruar përgjegjshmëri dhe kompensim.

Autoritetet ligjzbatuese mund të marrin pjesë gjithashtu në nisma bashkëpunimi ndërkombëtar siç janë ato që organizohen nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimet (UNODC), pasi ofrojnë hapësirë për shkëmbim ekspertize, përvojë dhe informacioni për praktikën e drejtësisë penale dhe parandalimin e krimeve ndaj gazetarëve. Shoqëria civile dhe sektori i medias gjithashtu duhet të përfshihen në këto nisma.

Shembuj

Bashkëpunimi për hetime të përmirësuara: Policia dhe Prokuroria holandeze, së bashku me Shoqatën holandeze të Kryeredaktorëve ranë dakord të përmirësojnë hetimet e sulmeve ndaj gazetarëve, përfshirë zbatimin e masave si regjistrimin sistematik të çështjeve, trajtimin me përparësi të sulmeve ndaj gazetarëve dhe ofrimin e informacionit në mënyrë më transparente dhe të aksesueshme për viktimat.¹

Lehtësimi i trajnimeve të përbashkëta për përmirësimin e dialogut: UNESCO ka lehtësuar dialogë dhe seminare të strukturuar për personelin ligjzbatues dhe gazetaret në vende të ndryshme si Ukraina, Nepali, Tunizia, Senegali, Tanzania, Somalia dhe Burkina Faso.²

Ftimi i më shumë aktorëve për dialog: Komisioni i UNODC për Parandalimin e Krimin dhe Drejtësi Penale zhvillon dialogë për Sigurinë e Gazetarëve ku përfshihen përfaqësues nga qeveritë dhe shoqëria civile.³

Ofrimi i trajnimeve tematike me shënjestrat e mundshme: Departamenti i Kërcënimeve Transnacionale i OSBE-së ka trajnuar policinë armene për të përmirësuar dialogun e tyre me shoqërinë civile gjatë demonstratave, me vëmendje të veçantë ndaj grave protestuese.⁴

Burimet

Pas një serie seminaresh ndërmjet zyrtarëve ligjzbatues dhe gazetarëve në Ukrainë, UNESCO ka publikuar një raport dhe video për të ndarë përvojën e tyre.⁵

¹ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), "Deklaratë e Përbashkët për krimet ndaj lirisë së shprehjes", 25 qershor 2012, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/91595>.

² Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Rezoluta 74/157, "Siguria e gazetarëve dhe çështja e sigurisë së gazetarëve dhe pandëshkueshmërisë", miratuar më 18 dhjetor 2019, <https://undocs.org/A/RES/74/157>.

³ OSBE, Përfaqësuesi për Lirinë e Medias, "Komunikatë për rritjen e kërcënimit ndaj sigurisë së gazetareve *online*", 6 shkurt 2015, <https://www.osce.org/fom/139186?download=true>.

⁴ William Horsley, *Udhëzuesi i OSBE-së për Sigurinë e Gazetarëve*, (Vjenë: Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias, 2012), <https://www.osce.org/fom/85777?download=true>.

⁵ OSBE, *Sfidat e Reja ndaj Lirisë së Shprehjes: Kundërvënja ndaj Abuzimit Online të Gazetareve*, (Vjenë: Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias, 2016).

⁶ Peter Noolander, "Për sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias, për Konferencën e Ministrave përgjegjës për Median dhe Shoqërinë e Informacionit", Punim i Përgjithshëm për zbatimin i KMrek(2016)4, Qipro, maj 2020, <https://rm.coe.int/background-paper-safety-of-journalists-and-other-media-actorsfinal/168094b396>.

⁷ "Manuali për Policinë dhe Prokurorët e Kurorës për Ngacmimin Penal", Qeveria e Kanadasë, Departamenti i Drejtësisë, <https://www.justice.gc.ca/eng/rp-pr/cj-jp/fv-vf/har/part1.html#cybstalk>.

⁸ UNESCO, *Liria e Shprehjes dhe Rendi Publik: Manuali i Trajnimit*, (Tuniz: UNESCO, 2015), <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000231305>.

⁹ "Trajnimi i Almatit për Lirinë e Shprehjes dhe Rendin Publik", lajm i UNESCO-s, 9 dhjetor 2019, <https://en.unesco.org/news/almaty-training-freedom-expression-and-public-order>.

¹⁰ ARTICLE 19, *Abuzimi dhe ngacmimi online me bazë gjinore ndaj gazetareve dhe platformat kryesore të medias sociale*, (Londër: ARTICLE 19, 2020), <https://www.article19.org/onlineharrassment>.

-
- ¹¹ Raportuesi i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara për vendimet jashtëgjyqësore, përmbledhëse dhe arbitrare, “Hetimi, përgjegjshmëria dhe parandalimi i vrasjeve të qëllimshme shtetërore të mbrojtësve të të drejtave të njeriut, gazetarëve dhe disidentëve të shquar”, (A/HRC/41/CRP.1), 19 qershor 2019, https://ap.ohchr.org/documents/dpage_e.aspx?si=A/HRC/41/36.
- ¹² Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias, “Rekomandimet në vijim të Takimit të Ekspertëve Sfidat e Reja për Lirinë e Shprehjes: Kundër Abuzimit Online ndaj Gazetarëve”, 17 shtator 2015, <https://www.osce.org/fom/193556?download=true>.
- ¹³ Te ai dokument, fundshënimi 12.
- ¹⁴ Deklarata e Përbashkët për Krimet kundër Lirisë së Shprehjes, Raportuesi i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara (OKB-së) për Lirinë e Mendimit dhe Shprehjes, Përfaqësuesi i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE-së) për Lirinë e Medias, Organizata e Shteteve Amerikane (OAS) Raportuesi i Posaçëm për Lirinë e Shprehjes dhe Komisioni Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve (ACHPR), Raportuesi i Posaçëm për Lirinë e Shprehjes dhe Aksesin në Informacion, prezantuar më 25 qershor 2012 <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/91595>.
- ¹⁵ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Rezoluta 39/6, “Siguria e gazetarëve”, miratuar më 27 shtator 2018, <https://undocs.org/A/HRC/RES/39/6>.
- ¹⁶ “Media Sociale- Udhëzime për ndjekjen penale të çështjeve që kanë të bëjnë me komunikime të dërguara përmes mediave sociale”, Prokuroria e Kurorës, <https://www.cps.gov.uk/about-cps>.
- ¹⁷ Petrit Çollaku, *Treguesit e Kosovës mbi nivelin e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve*, (Shoqata e Gazetarëve të Kosovës, 2018).
- ¹⁸ Procuraduría General de la República, Estados Unidos Mexicanos, “Protocolo homologado de Investigación de delitos cometidos contra la libertad de expresión”, https://www.gob.mx/cms/uploads/attachment/file/444272/Protocolo_homologado_de_investigaci_n_de_delitos_cometidos_contra_la_libertad_de_expresi_n.pdf.
- ¹⁹ “Marrëveshja e Grupit Drejtues për Agresionin dhe dhunën ndaj gazetarëve”, (Përkthim jozyrtar nga Tarlach McGonagle), Hagë, 2018, <https://www.ivir.nl/publicaties/download/Agreement-of-the-Steering-Group-on-Aggression-and-violence-against-journalists-EN-translation.pdf>.
- ²⁰ “Partnerët e UNESCO-s me Ministrinë e Brendshme tuniziane për përmirësimin e sigurisë së gazetarëve”, lajm i UNESCO-s, 2019, <https://fr.unesco.org/nees/l%E2%80%99unesco-et-le-minist%C3%A8re-de-l%E2%80%99int%C3%A9rieur-de-la-tunisie-coop%C3%A8rent-pour-am%C3%A9liorer-la-s%C3%A9curit%C3%A9-des>.
- ²¹ “Siguria e Gazetarëve: Raporti për Aktivitetin Plotësues UNODC CCCPCJ”, Këshilli Akademik i Sistemit të Kombeve të Bashkuara, 7 korrik 2014, <https://acuns.org/the-safety-of-journalists-report-on-unodc-cccpcj-side-event/>.
- ²² “Filmi për trajnimin e oficerëve ligjzbatues ukrainas mbi lirinë e shprehjes dhe sigurinë e gazetarëve”, lajm i UNESCO-s, 11 prill 2018, <https://en.unesco.org/nees/film-training-ukrainian-la%C3%A9-enforcement-officers-freedom-expression-safety-journalists>.